



Embassy
of the Federal Republic of Germany
Pristina

FOL



KOSOVO LAW INSTITUTE
INSTITUTI I KOSOVES PËR DREJTËSI
KOSOVSKI INSTITUT PRAVDE

INPO
Iniciativa për progres

Përmbledhje e rasteve nga praktika gjyqësore e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GjEDNj)



Përmbledhje e rasteve nga praktika gjyqësore e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GjEDNj)

TITULLI:

Përmbledhje e rasteve nga praktika gjyqësore e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GjEDNJ)

AUTOR:

Lëvizja FOL

VITI I BOTIMIT:

2025

PUBLIKUAR NGA:

Lëvizja FOL

WEBSITE:

www.levizjafol.org

ADRESA:

Tringë Smajli, H6/5, Prishtinë 10000, Republika e Kosovës

Publikimi i këtij raporti mbështetet nga Ambasada e Gjermanisë në Kosovë dhe është implementuar nga Lëvizja FOL, Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD) dhe Iniciativa për Progres (INPO). Opinonet dhe rekomandimet në këtë raport janë të autorëve dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e donatorit.

Të drejtat e autorit © 2025. Të gjitha të drejtat e rezervuara. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet, ruhet në një sistem rikthimi, ose transmetohet, në çfarëdo forme apo mjeti, elektronik, mekanik, fotokopjues, incizues ose ndryshe, pa pëlqimin paraprak me shkrim të botuesit.

Përmbatja

Lista e shkurtesave	6
Hyrje	7
Metodologjia	8
1. Rasti Danileț kundër Rumanisë (Nr. 16915/21).....	9
2. Rasti Humpert dhe të tjerët kundër Gjermanisë (Nr. 59433/18, 59477/18, 59481/18 dhe 59494/18)	11
3. Rasti Sanchez kundër Francës [dhm] (Nr. 45581/15)	13
4. Rasti M.B. kundër Holandës (Nr. 71008/16)	15
5. Rasti Pricope kundër Rumanisë (nr. 60183/17)	17
6. Rasti Tërshana kundër Shqipërisë (Nr. 48756/14)	19
7. Rasti Simonova Kundër Bullgarisë (Nr. 30782/16)	21
8. Rasti Bagirova dhe të tjerët kundër Azerbajxhanit (Nr. 37706/17 dhe të tjerat).....	23
9. Rasti Macatè kundër Lituanisë (Nr. 61435/19)	25
10. Rasti Zorina International SRL kundër Rumanisë (Nr. 15553/15)	27
11. Rasti Yordanov dhe të tjerët kundër Bullgarisë (Nr. 265/17 dhe 26473/18)	29
12. Rasti Osmani kundër Shqipërisë (nr. 8706/18).....	31
13. Rasti Altius Insurance Ltd Kundër Qipros (Nr. 41151/20)	33
14. Rasti Ben Amamou Kundër Italisë (Nr. 49058/20)	35
15. Rasti Plechlo Kundër Sllovakisë (Nr. 18593/19)	37
16. Rasti X Kundër Greqisë (Nr. 38588/21)	39
17. Rasti Matyushonok Kundër Ukrainës (Nr.34590/06)	41
18. Rasti Wieder Dhe Guarnieri Kundër Mbretërisë Së Bashkuar (Nr. 64371/16 Dhe 64407/16)	43
19. Kompania E Transmetimit Radio B92 Ad Kundër Serbisë (Nr. 67369/16)	45
20. Vučković Kundër Kroacisë (Nr. 15798/20)	47
21. Gashi Dhe Gina Kundër Shqipërisë (Nr.29943/18).....	49
Lista e Rasteve	51

Lista e Shkurtesave

KE	Këshilli i Evropës: Organizatë ndërkombëtare që promovon demokracinë, të drejtat e njeriut dhe sundimin e ligjit në Evropë.
KEDNj	Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut: Traktat ndërkombëtar që mbron të drejtat dhe liritë themelore të individëve në shtetet anëtare të Këshillit të Evropës.
GjEDNj	Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut: Institucion gjyqësor i Këshillit të Evropës që siguron respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të garantuara nga Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut.
DhM	Dhoma e Madhe e GjEDNj: Organ gjyqësor brenda GjEDNj-së që shqyrton çështje të një rëndësie të veçantë ose apeline ndaj vendimeve të dhomave më të vogla të Gjykatës.
Prot.	Protokolli i KEDNj: Amendament ose shtesë e Konventës që vendos të drejta dhe detyrime të reja për shtetet nënshkruese.
Kërkuesi	Ankuesi në GjEDNj: Personi ose grupi i personave që paraqesin një ankesë në GjEDNj duke pretenduar shkelje të të drejtave të tyre të garantuara nga KEDNj.

Hyrje

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GjEDNJ) është një nga institucionet më të rëndësishme për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave dhe lirive themelore në Evropë. Jurisprudenca e saj ka luajtur një rol kyç në harmonizimin dhe forcimin e standardeve për mbrojtjen e të drejtave të njeriut në të gjitha shtetet anëtare të Këshillit të Evropës (KE), të cilat janë palë në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ). Vendimet e GjEDNJ-së shërbejnë si precedentë të rëndësishëm dhe kanë ndikuar në mënyrë domethënëse në mbrojtjen e të drejtave të individëve.

Kosova, pavarësisht se ka shpallur pavarësinë më 17 shkurt 2008 dhe ka ndërtuar një sistem institucional dhe juridik të konsoliduar, ende përballet me sfida në arenën ndërkombëtare, përfshirë njohjen dhe anëtarësimin në organizata të rëndësishme si Këshilli i Evropës. Mungesa e anëtarësimit në KE dhe e nënshkrimit të KEDNJ-së krijon një boshllëk të rëndësishëm, pasi qytetarët e Kosovës nuk kanë qasje të drejtpërdrejtë në GjEDNJ për të kërkuar drejtësi në rastet e shkeljeve të të drejtave të tyre.

Megjithatë, përkushtimi i Kosovës për të forcuar pozitën e saj ndërkombëtare reflektohet në përpjekjet e vazhdueshme për harmonizimin e legjislationit vendor me standardet evropiane dhe për sigurimin e një zbatimi efektiv të tyre. Anëtarësimi në KE do të ishte një hap strategjik për Kosovën, duke i mundësuar qytetarëve të saj të kenë qasje në GjEDNJ dhe duke kontribuar në forcimin e sundimit të ligjit dhe të të drejtave të njeriut.

Edhe pse qytetarët e Kosovës nuk kanë ende qasje të drejtpërdrejtë në GjEDNJ, vendimet e kësaj gjykate mbeten një burim i rëndësishëm reference për juristët dhe gjyqtarët kosovar. Jurisprudenca e saj, përfshirë raste mbi të drejtat pronësore, lirinë e shprehjes, barazinë para ligjit dhe ndalimin e diskriminimit, mund të shërbejë si udhërrëfyese për interpretimin dhe zbatimin e normave juridike në Kosovë. Përqasja e standardeve ndërkombëtare në kornizën ligjore kombëtare do të përmirësonte cilësinë e drejtësisë dhe do të ndihmonte në ngritjen e reputacionit të Kosovës si një shtet që respekton të drejtat e njeriut dhe sundimin e ligjit.

Pavarësisht sfidave, Kosova mund të fillojë të përvetësojë dhe të zbatojë standardet e avancuara të GjEDNJ-së edhe përpara anëtarësimit në KE. Kjo mund të arrihet përmes reformave të vazhdueshme në sistemin e drejtësisë, përmirësimit të infrastrukturës juridike dhe harmonizimit të legjislationit kombëtar me praktikën më të mira evropiane. Për më tepër, përfshirja e juristëve, gjyqtarëve dhe politikëbërësve në trajnime ndërkombëtare dhe shkëmbime profesionale do të ndihmonte në rritjen e kapaciteteve për respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

Përmes analizës së jurisprudencës evropiane, kjo përmbledhje rastesh ofron një udhëzues praktik për juristët, gjyqtarët, avokatët dhe politikëbërësit, duke ndihmuar në harmonizimin e praktikave vendore me standardet ndërkombëtare të drejtësisë dhe të drejtave të njeriut.

Metodologjia

Ky raport përmbledhës i rasteve nga praktika gjyqësore e GjEDNJ-së ka për qëllim të analizojë dhe interpretojë vendimet më të rëndësishme të GjEDNJ-së të viteve të fundit, me fokus në vendimet që janë të përafërta me rrethanat e Kosovës.

Qëllimi i raportit është të ofrojë një pasqyrë të qartë të praktikave më të avancuara në mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe të ndihmojë juristët, studiuesit dhe politikëbërësit në Kosovë të përvetësojnë këto standarde në sistemin juridik kombëtar.

Gjithashtu, kjo përmbledhje synon të frymëzojë dhe të orientojë zhvillimin e mëtejshëm të sistemit juridik të Kosovës, duke kontribuar në forcimin e sundimit të ligjit dhe mbrojtjen efektive të të drejtave të njeriut. Këto elemente janë themelore për ndërtimin e një shoqërie demokratike dhe gjithëpërfshirëse, si dhe për përparimin e Kosovës në rrugën e saj drejt integritetit evropian.

Për nevojat e këtij raporti është përdorur baza e të dhënave zyrtare të GjEDNJ-së, raportet e jurisprudencës, dhe publikime nga organizata të specializuara për të drejtat e njeriut. Vendimet janë interpretuar duke shqyrtuar arsyetimet ligjore të GjEDNJ-së, interpretimin e KEDNJ-së, dhe ndikimin e vendimeve në standardet juridike evropiane.

1. Rasti Danileț kundër Rumanisë

(Nr. 16915/21)



Vendimi Gjyqësor i datës 24 shkurt 2024

Ky rast thekson detyrimin e shteteve anëtare të Këshillit të Evropës për të mbrojtur dhe garantuar lirinë e shprehjes për gjyqtarët, veçanërisht kur ata trajtojnë çështje me interes të madh publik. GjEDNJ riafirmoi se gjyqtarët nuk duhet të ndëshkohen për shprehjen e mendimeve mbi çështjet që prekin drejtësinë dhe pavarësinë e sistemit gjyqësor. Në të kundërtën, veprimet e tilla përbëjnë shkelje të nenit 10 të KEDNJ -së (liria e shprehjes)¹.

Rasti Danileț kundër Rumanisë² në GjEDNJ trajton një çështje të rëndësishme që përfshin lirinë e shprehjes për gjyqtarët dhe kufijtë e vendosur nga rregullat disiplinore të brendshme të sistemit gjyqësor rumun.

Danileț, i cili ishte gjyqtar dhe figurë e njohur publike për qëndrimet e tij në favor të reformës gjyqësore në Rumani, u ndëshkua nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë për shkak të disa postimeve dhe deklaratave të tij publike, ku ai kishte kritikuar problemet me korrupsionin dhe ndërhyrjet politike në sistemin gjyqësor rumun, si dhe për dështimet në zbatimin e reformave në drejtësi.

Me 9 janar 2019, Danileț postoi tekstin e mëposhtëm në faqen e tij në Facebook:

"Mund të keni vënë re një varg përpjekjesh për të sulmuar, përçarë dhe diskredituar institucionet, si Drejtoria e Përgjithshme e Informacionit dhe Mbrojtjes së Brendshme, Shërbimi Informativ Rumun, policia, Drejtoria Kombëtare Kundër Korrupsionit, xhandarmëria, Gjykata e Lartë e Kasacionit dhe Zyra e Prokurorit Publik të Drejtësisë, Gjykata e Lartë e Kasacionit dhe e Drejtësisë dhe ushtria. Sulmet në fjalë nuk ndodhën thjesht rastësisht pas 'abuzimeve të kryera nga pushtetet që janë'. A e kuptojnë njerëzit se çfarë do të thotë të dobësohen këto institucione ose, më keq, të rikthehen shërbimet, policia, gjykatat dhe ushtria nën kontrollin politik?...".

Më 10 janar 2019, përsëri në faqen e tij në Facebook, gjyqtari postoi një lidhëz për një artikull shtypi me titull:

"Një prokuror jep alarmin. Të jetosh në Rumani sot paraqet një rrezik të madh. Vija e kuqe është kapërcyer kur bëhet fjalë për sistemin e drejtësisë", e cila ishte publikuar në një faqe kombëtare lajmesh.

Në intervistën në të cilën bazohej artikulli në fjalë, C.S., prokuror, kishte dhënë këndvështrimin e tij mbi mënyrën se si prokuroria publike po trajtonte çështjet penale dhe për vështirësitë e prokurorëve në trajtimin e rasteve që u ishin ngarkuar.

1 Çdokush ka të drejtën e lirisë së shprehjes. Kjo e drejtë përfshin lirinë e mendimit dhe lirinë për të marrë ose për të dhënë informacione dhe ide pa ndërhyrjen e autoriteteve publike dhe pa marrë parasysh kufijtë. Ky nen nuk i ndalon Shtetet që t'u kërkojnë ndërmarrjeve të transmetimit audioviziv, televiziv ose kinematografik të pajisen me licencë.

2 Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, rasti Danileț kundër Rumanisë, nr. 16915/21, 24 shkurt 2024.

Pas këtyre postimeve, Bordi i Inspektimit Gjyqësor (BIGj) inicioj procedurë disiplinore ndaj Danilet për shkak të cenimit të nderit dhe reputacionit të gjyqësorit. Duke i'u referuar dispozitave të Kodit të Etikës për Gjyqtarët dhe Prokurorët, BIGj pretendonte se Danilet nuk kishin përmbushur detyrën e tij dhe në këtë mënyrë kishin dëmtuar reputacionin e mirë të gjyqësorit.

Rrjedhimisht, Bordi Disiplinor konsideroi se Danilet kishin shkelur rregullat e sjelljes që zbatoheshin përgjithësisht për gjyqtarët dhe prokurorët duke i shkaktoar dëm sistemit të drejtësisë në tërësi, si dhe urdhëroi që paga e tij të shkurtohej me 5% për dy muaj. Sipas bordit, ky sanksion do të shërbente si një paralajmërim për pasojat e mundshme të adoptimit të sjelljeve të ngjashme në të ardhmen.

Kërkuesi e apeloj këtë vendim në Gjykatën e Lartë, duke argumentuar se vendimi disiplinor ishte i paligjshëm dhe i pabazuar. Ai pretendoi se nuk kishte asnjë provë, duke përfshirë deklaratat e marra nga Bordi i Inspektimit Gjyqësor për ndonjë dëm të shkaktoar në reputacionin e mirë të gjyqësorit. Detyra e diskrecionit, pohoi ai, zbatohet vetëm për zyrën e gjyqtarit dhe për çështjet në pritje që i ishin caktuar, jo për angazhimin e tij me komunitetin.

Ndërkaq Gjykata e Lartë e rrëzoi ankimin e ankuesit dhe e la në fuqi vendimin disiplinor, me arsyetimin se Bordi Disiplinor në shqyrtimin e ligjshmërisë së sanksionit, kishte marrë parasysh të gjitha elementet thelbësore të rastit disiplinore.

Ndërkaq, GjEDNJ pas shqyrtimit të rastit konstatoi se gjykatat e brendshme kishin dështuar t'i kushtonin vëmendjen e duhur disa faktorëve të rëndësishëm, veçanërisht në lidhje me kontekstin më të gjerë në të cilin ishin bërë deklaratat e parashtuesit të kërkesës, pjesëmarrjen e tij në një debat mbi çështjet me interes publik, çështjen nëse gjykimet vlerësuese të shprehura kishin qenë mjaftueshëm të bazuara në fakte dhe, së fundi, efektit potencialisht të frikshëm të sanksionit.

Përveç kësaj, ekzistenca e një sulmi ndaj dinjitetit dhe nderit të profesionit të gjyqtarit nuk ishte demonstruar mjaftueshëm. Në vendimet e tyre, gjykatat kombëtare nuk i kishin dhënë lirisë së shprehjes së parashtuesit të kërkesës peshën dhe rëndësinë që i takonte në dritën

e praktikës gjyqësore të Gjykatës, edhe pse ishte përdorur një mjet komunikimi (përkatesisht një llogari në Facebook e qasshme nga publiku) që mund të ketë ngritur çështje legjitime në lidhje me respektimin e detyrës së vetëpërmbytjes nga gjyqtarët. Rrjedhimisht, gjykatat rumune nuk kishin dhënë arsye relevante dhe të mjaftueshme për të justifikuar ndërhyrjen e pretenduar në të drejtën e parashtuesit të kërkesës për lirinë e shprehjes.

Në këtë mënyrë, GjEDNJ-ja:

- Konfirmoi rëndësinë e lirisë së shprehjes për gjyqtarët, sidomos kur ata trajtojnë çështje që kanë interes të madh publik, si korrupsioni dhe reformat në drejtësi.
- Shprehu shqetësimin se masat ndëshkuese ndaj Danilet mund të krijojnë një efekt frikësues (chilling effect) ndaj gjyqtarëve të tjerë, duke i dekurajuar ata të shprehen për probleme që prekin pavarësinë e drejtësisë.
- Theksoi se liria e shprehjes duhet të balancohet me detyrimin e gjyqtarëve për të ruajtur besimin e publikut në paanshmërinë dhe integritetin e tyre. Megjithatë, në këtë rast, Gjykata vlerësoi se ndëshkimi nuk ishte proporcional dhe cenonte të drejtën e Danilet për të shprehur mendimet e tij.

Rrjedhimisht, GjEDNJ vendosi se ndëshkimi disiplinor ndaj Danilet përbënte shkelje të nenit 10 të KEDNJ-së, duke i dhënë rëndësi lirisë së shprehjes për gjyqtarët si një element kritik për mbrojtjen e pavarësisë së sistemit gjyqësor dhe forcimin e demokracisë.

2. Rasti Humpert dhe të tjerët kundër Gjermanisë

(Nr. 59433/18, 59477/18, 59481/18 dhe 59494/18)
Bottom of Form



Vendim gjyqësor i datës 14 dhjetor 2023

Ky rast thekson të drejtat dhe kufizimet e sindikalizmit për nëpunësit civil në kontekstin e detyrimeve të tyre ndaj shtetit. GjEDNJ vendosi se ndalimi i grevave për mësimdhënësit me statusin e nëpunësve civil në Gjermani nuk përbënte shkelje të nenit 11 të Konventës (liria e tubimit paqësor dhe e anëtarësimit në sindikata)³, duke argumentuar se ky kufizim synonte të garantonte funksionimin efektiv të administratës publike dhe qëndrueshmërinë e shërbimeve arsimore.

Rasti Humpert dhe të tjerët kundër Gjermanisë⁴ ofron një precedent të rëndësishëm mbi kufijtë e të drejtave sindikale për nëpunësit civil dhe mënyrën se si këto të drejta mund të kufizohen në interes të funksionimit efektiv të shtetit dhe mbrojtjes së të drejtave themelore.

Rasti përfshinte katër mësimdhënësit të shkollave publike gjermane me status të nëpunësve civil, të cilët u ndëshkuan për pjesëmarrje në greva në lidhje me kushtet e punës, të organizuar nga sindikata e tyre gjatë orarit të punës. Më pas, ndaj të njëjtëve u iniciuar procedura disiplinore nga organet kompetente për

shkeljen e detyrave të tyre si nëpunës civilë, për shkak të pjesëmarrjes në greva gjatë kohëzgjatjes së orarit të punës.

Autoriteti kompetent nxori një vendim disiplinor kundër tyre, me ç'rast u shqiptoj gjopa administrative për shkak të mungesë së paautorizuar nga puna. Gjithashtu, të njëjtët u obliguan të mos vazhdonin grevën.

Si pasojë e këtyre vendimeve, kërkuesit u drejtuan në gjykatat administrative vendore me qëllim të anulimit të vendimeve disiplinore, por të njëjtat dështuan, për shkak se të gjitha gjykatat administrative konstatuan se kërkuesit kishin shkelur detyrat e tyre profesionale duke marrë pjesë në këto greva.

Rrjedhimisht, kërkuesit, të cilët të gjithë ishin të përfaqësuar ligjërisht, parashtuan ankesa të veçanta kushtetuese në Gjykatën Kushtetuese Federale kundër vendimeve disiplinore të shqiptuara ndaj tyre, të konfirmuar nga gjykatat administrative. Ata pretenduan se vendimet, të cilat rezultuan nga ndalimi i grevës nga mësuesit me statusin e nëpunësit civil, kishin shkelur të drejtën e tyre për të krijuar shoqata për të mbrojtur dhe përmirësuar kushtet e punës dhe ekonomike. Ata argumentuan se gjykatat administrative kishin dështuar të interpretonin ligjin kombëtar në përputhje me të drejtën ndërkombëtare publike, pasi ndalimi i grevës nga

³ Çdokush ka të drejtën e lirisë së tubimit paqësor dhe të organizimit me të tjerët, duke përfshirë të drejtën e themelimit me të tjerë të sindikatave dhe të pjesëmarrjes në to për mbrojtjen e interesave të tij.

⁴ Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Rasti Humpert dhe të tjerët kundër Gjermanisë, nr. 59433/18, 59477/18, 59481/18 dhe 59494/18), 14 dhjetor 2023.

mësuesit me status nëpunësi civil, të cilët nuk mbanin detyra që përfshijnë ushtrimin e elementeve thelbësore të autoritetit publik, shkeli, në veçanti, nenin 11 të Konventës.

Gjykata Kushtetuese Federale konstatoi se vendimet disiplinore kundër kërkuesve, nuk kishin shkelur të drejtën e kërkuesve për të krijuar shoqata për të mbrojtur dhe përmirësuar kushtet e punës. Gjithashtu, sipas mendimit të Gjykatës Kushtetuese Federale, ndalimi i grevës nga nëpunësit civilë sipas ligjit gjerman ishte gjithashtu në përputhje me nenin 11 të Konventës dhe me praktikën gjyqësore të kësaj gjykate në lidhje me të drejtën e grevës.

Palët, me pretendimet se ndalimi i grevave të shërbyesve civil përbënte shkelje të nenit 11 të Konventës (liria e tubimit paqësor dhe e anëtarësimit në sindikata), parashtruan ankesë në GjEDNJ.

Pas shqyrtimit të ankesës, GjEDNJ konstatoi se ndalimi i grevës së mësimdhënësve ishte në përputhje me ligjin gjerman dhe synonte të siguronte funksionimin efektiv të administratës publike. Mësimdhënësit si nëpunës civil kishin detyrime të veçanta për të garantuar qëndrueshmërinë e shërbimeve publike, veçanërisht me sektorin e arsimit.

Gjykata vuri në dukje se, ndonëse ligji gjerman nuk e parashihte shprehimisht ndalimin e mbajtjes së grevës për shërbyesit civil, sipas nenit 47 të Statusit të Nëpunësve Civil, i cili zbatohet për nëpunësit civil, nëpunësit civil kryejnë shkelje disiplinore nëse shkelin detyrat e tyre. Sipas këtij ligji, detyra të tilla përfshijnë detyrën për t'u përkushtuar plotësisht gjatë ushtrimit të profesionit. Rrjedhimisht, se nëpunësit civil nuk duhet të mungojnë në punë pa leje.

Gjykata vuri në dukje gjithashtu se, ndonëse mësuesit nuk kishin të drejtë të mungonin në punë, ata mund të mbronin interesat e tyre profesionale përmes dialogut institucional dhe mekanizmave të negociatave kolektive.

Rrjedhimisht, GjEDNJ mbështeti interpretimin e Gjykatës Kushtetuese Federale të Gjermanisë, duke theksuar se ndalimi është bërë në përputhje me të drejtën ndërkombëtare dhe KEDNJ-në.



Gjykata theksoj se, ndonëse disa vende po priren të lejojnë grevat për nëpunësit civil, ndalimi në Gjermani ishte në përputhje me praktikën ndërkombëtare dhe brenda marzhit të vlerësimit të shtetit për rregullimin e shërbimeve publike.

3. Rasti sanches kundër Francës [dhm] (Nr. 45581/15)



Vendim gjyqësor i datës 15 maj 2023

GjEDNJ konstatoi se figurat publike që administrojnë ndonjë hapësirë publike në internet kanë detyrimin të ndërmarrin masa për të ndaluar përhapjen e gjuhës së urrejtjes dhe komenteve diskriminuese nga palë të treta. GjEDNJ konfirmoi se ndonëse liria e shprehjes është një e drejtë themelore, ajo nuk mbrohet kur përdoret për të përhapur urrejtje dhe dhunë ndaj grupeve të caktuara.

Rasti Sanches kundër Francës⁵ trajton përgjegjësinë e një politikani për mos heqjen e komenteve islamofobe të postuara nga palë të treta në "murin" e tij personal në rrjetin social Facebook gjatë një fushate zgjedhore.

Kërkuesi ishte këshilltar lokal dhe garonte për zgjedhje në Parlament për partinë Fronti Kombëtar (FN). Në shtator 2011, kërkuesi postoi një mesazh në llogarinë e tij në Facebook, i cili u pasua me komente të palëve të treta me përmbajtje islamofobike dhe nxitëse kundër personave me besim mysliman. Komentet qëndruan të dukshme për një periudhë kohore pa u fshirë nga kërkuesi, pavarësisht se ishte i informuar për përmbajtjen e tyre. Ditën tjetër, kërkuesi postoi një mesazh në "murin" e tij, ku ftoi përdoruesit të ishin më të kujdesshëm me përmbajtjen e komenteve të tyre; megjithatë, ai nuk ndërhyri në lidhje me komentet e postuara.

Rrjedhimisht, në vitin 2013, kërkuesi dhe komentuesit e sipërpërmendur u dënuan për nxitje të urrejtjes ose dhunës kundër një grupi ose individi për shkak të origjinës së tyre ose faktit të përkatësisë ose jo në një grup etnik, komb, racë ose fe të caktuara.

Në veçanti, nga vendimet rezultoi se komentet për-caktonin qartë grupin në fjalë, përkatësisht personat e besimit mysliman, dhe se lidhja e komunitetit mysliman me krimin dhe pasigurinë kishte gjasa të ngjallte një ndjenjë të fortë refuzimi ose armiqësie ndaj atij grupi. Kërkuesi u shpall fajtor si autori kryesor. Ai kishte krijuar një shërbim online për komunikim ("murin" e Facebook-ut) dhe e bëri atë të hapur për publikun, ndaj kishte marrë përgjegjësinë për përmbajtjen e komenteve ofenduese të postuara. Për më tepër, statusi i tij si politikan kërkonte që ai të ishte edhe më i kujdesshëm. Në këtë çështje, ai nuk kishte vepruar menjëherë për të ndaluar shpërndarjen e këtyre komenteve ofenduese. Dy komentuesit u shpallën fajtorë si bashkëpunëtorë.

Në lidhje me këtë, Sanches u drejtua në GjEDNJ me pretendimin se dënimi i tij shkelte të drejtën e tij për lirinë e shprehjes sipas nenit 10 të KEDNJ-së.

Në maj 2023, GjEDNJ vendosi se nuk kishte pasur shkelje të nenit 10. Gjykata arsyetoi se ndërhyrja e autoriteteve vendore franceze ka qenë "e nevojshme në një shoqëri demokratike".

5 Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Rasti Sanches kundër Francës, Nr. 45581/15, Vendim gjyqësor i datës 15 maj 2023.

Sipas GjEDNJ-së, vendimet e gjykatave vendase ishin të bazuara dhe të arsyetuara mjaftueshëm sa i përket përgjegjësisë që i atribuohet kandidatit, në cilësinë e tij si politikan, për komentet e paligjshme të postuara në prag të zgjedhjeve në "murin" e tij në Facebook nga persona të tretë.

Sipas GjEDNJ-së, qëllimi i dënimit ishte i drejtë, për shkak se synonte të mbronte të drejtat dhe reputacionin e të tjerëve (veçanërisht komunitetit mysliman) si dhe të parandalonte përhapjen e gjuhës së urrejtjes.

GjEDNJ theksoj se, figurat publike, përfshirë politikanët, kanë një përgjegjësi më të madhe për të mbrojtur normat demokratike dhe të drejtat e të tjerëve, për shkak të ndikimit që ushtron pozita e tyre. Gjykata theksoj se komentet islamofobike qëndruan në llogarinë e aplikantit dhe nuk u fshinë deri pas ndërhyrjes së autoriteteve. GjEDNJ e konsideron këtë mosveprim si një shkelje të standardeve të përgjegjësisë, duke theksuar se aplikanti, si administrator i llogarisë, duhej të ndërmernte masa për të ndaluar përhapjen e dhunës. Pra si rrjedhojë, sipas GjEDNJ-së, vendimi nuk ishte i tepruar dhe ishte në proporcion me qëllimin për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve.



Ky rast krijon një precedent të rëndësishëm për mirëmbajtjen e rrjeteve sociale dhe vendos standarde të qarta për përgjegjësinë e administratorëve të platformave publike në mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe luftimin e diskriminimit.

4. Rasti M.B. kundër Holandës

(Nr. 71008/16)



vendimi gjyqësor i datës 23 prill 2024

Autoritetet kombëtare mund të ndalojnë azilkërkuesit për shkak të hyrjes së tyre të paautorizuar edhe pas paraqitjes së kërkesës së tyre për azil dhe në pritje të vendimit. Megjithatë, ndalimi për qëllime imigracioni duhet të bazohet në legjislacionin kombëtar dhe nuk duhet të jetë arbitrar, që do të thotë se duhet të ekzistojë një lidhje mjaft e ngushtë ndërmjet ndalimit për qëllime imigracioni dhe parandalimit të hyrjes së paautorizuar. Mosveprimi në këtë mënyrë përbën shkelje të nenit 5, par.1 (f) të KEDNJ-së⁶ (E drejta për liri dhe siguri - Ndalimi arbitrar i azilkërkuesve dhe të huajve).

Në rastin M.B kundër Holandës⁷, GjEDNJ trajton çështjen e ndalimit të një azilkërkuesi për arsye të imigracionit, pas përfundimit të paraburgimit dhe gjatë pritjes së vendimarrjes mbi kërkesën e tij për azil.

Kërkuesi është shtetas sirian i cili ka hyrë në Holandë në tetor 2015 dhe ka aplikuar për azil. Menjëherë pas kësaj, ai u arrestua nën dyshimin për pjesëmarrje në një organizatë terroriste ndërmjet marsit 2013 dhe tetorit 2015 dhe u vendos në paraburgim.

Në gusht 2016, gjykata penale e dënoi kërkuesin e akuzuar me dhjetë muaj burg (duke zbritur kohën që ai kishte kaluar në paraburgim). Vendimi i gjykatës penale u bazua në disa prova (p.sh., deklaratimet e kërkuesit, deklaratimet e dëshmitarit, një mesazh nga kërkuesi në vitin 2013, biseda në WhatsApp e vitit 2015 dhe foto dhe video të gjetura në telefonin e tij celular).

Prokurori ashtu edhe kërkuesi u ankuan ndaj këtij vendimi. Rrjedhimisht, në një vendim gjyqësor të vitit 2017, gjykata e shkallës së dytë e rrëzoi pjesërisht ankimin për shkak të mungesës së kompetencës për njërën nga akuzat dhe, për sa i përket akuzave të tjera, e liroi kërkuesin për mungesë provash të mjaftueshme.

Paraburgimi i kërkuesit u ndërpre më 23 shtator 2016. Në të njëjtën ditë, ai u ndalua për qëllime imigracioni në pritje të vlerësimit të kërkesës së tij për azil, për shkak se kërkuesi përfaqësonte kërcënim për sigurinë kombëtare ose rendin publik nisur nga dënimi i tij penal, si dhe për t'ju mundësuar autoriteteve shqyrtimin e kërkesës së tij për azil.

Kërkuesi qëndroi në ndalim për qëllime imigracioni deri në dhjetor 2016, kur u vendos një masë më pak kufizuese: ai duhej të paraqitej çdo ditë tek autoritetet dhe të kërkonte leje për të lëvizur jashtë bashkisë ku jetonte. Autoritetet holandeze e justifikuan ndalimin e tij duke u mbështetur në nenin 5, paragrafi 1(f) të KEDNJ, i cili lejon ndalimin e një individi për të parandaluar hyrjen e tij të paautorizuar në një shtet. Ata argumentuan se azilkërkuesi ende nuk kishte hyrë formalisht në Holandë sipas kuptimit ligjor të hyrjes, edhe pse ai ndodhej fizikisht në territorin e vendit. Kjo masë u hoq në vitin 2018, dhe atij iu miratua kërkesa për azil.

6 Çdokush ka të drejtën e lirisë e të sigurisë personale. Askujt nuk mund t'i hiqet liria, me përjashtim të rasteve që vijnë dhe në përputhje me procedurën e parashikuar me ligj: kur arrestohet ose ndalohet ligjërisht me qëllim që të ndalohet hyrja e tij e paautorizuar në atë vend, ose nëse kundër tij është duke u kryer një procedurë dëbimi ose ekstradimi.

7 M.B kundër Holandës, Kërkesa nr. 71008/16, 23 prill 2024.

GjEDNJ konstatoj se, në kohën e ndalimit të kërkuesit, autoritetet kombëtare nuk kishin marrë një vendim për kërkesën e tij për azil. Në këtë kontekst, e drejta për të qëndruar në territorin e një Shteti në pritje të rezultatit të një kërkesë për azil nuk mund të barazohet me të drejtën për leje qëndrimi. Prandaj, ndalimi i kërkuesit për shkak të "hyrjes së paautorizuar" ishte në përputhje me nenin 5, par.1 (f) të KEDNJ-së.

Në lidhje me arbitraritetin e ndalimit të kërkuesit, Gjykata shqyrtoi nëse ekzistonte një lidhje mjaft e ngushtë ndërmjet ndalimit për qëllime të imigracionit dhe qëllimit të parandalimit të hyrjes së tij të paautorizuar. Për më tepër, gjatë paraburgimit të kërkuesit (nëntor 2015 - shtator 2016), autoritetet nuk morën asnjë masë për të vlerësuar kërkesën e tij për azil. Përkundrazi, autoritetet kryen intervista për azil kur kërkuesi ndodhej në ndalim për qëllim imigracioni (shtator 2016 - dhjetor 2016). Rrjedhimisht, ky ndalim për qëllim imigracioni duket jo proporcional dhe i panevojshëm, pasi shumë nga hapat e kërkuar për vlerësimin e kërkesës për azil mund të ishin ndërmarrë gjatë paraburgimit sipas legjislacionit penal, pa qenë nevoja për të mbajtur më pas kërkuesin në ndalim për qëllime imigracioni.

Gjykata vuri re se autoritetet holandeze e përdorën sigurinë kombëtare dhe rendin publik si justifikim për ndalimin e kërkuesit pas lirimit të tij nga paraburgimi penal. Megjithatë, GjEDNJ theksoi se ndalimi për qëllime të rendit publik nuk përputhet me nenin 5(1)(f), pasi kjo dispozitë lidhet vetëm me ndalimin për të parandaluar hyrjen e paautorizuar ose për të mundësuar largimin e një individi nga shteti.

Nëse një person ka përfunduar ndalimin penal, ai nuk mund të mbahet në paraburgim për arsye të sigurisë kombëtare nën maskën e ndalimit për imigracion. Rrjedhimisht, GjEDNJ konstatoi se ndalimi i kërkuesit për qëllime imigracioni u zgjat pa arsye të mjaftueshme dhe pa veprime aktive të autoriteteve për shqyrtimin e kërkesës për azil. Nëse synimi ishte vlerësimi i kërkesës së tij për azil, autoritetet mund të kishin ndërmarrë hapat e nevojshëm gjatë paraburgimit penal dhe jo më pas.

Nisur nga sa më sipër, Gjykata konstaton se Holanda ka shkelur nenin 5 par.1(f) të KEDNJ-së për shkak të ndalimit arbitrar të kërkuesit për qëllime imigracioni në pritje të kërkesës së tij për azil për shkaqe të rendit publik.



Ky vendim forcon standardet mbi kufijtë e ndalimit për arsye të imigracionit dhe thekson se ndalimi nuk mund të përdoret si mjet i fshehtë për të justifikuar mbajtjen e një individi për arsye të rendit publik ose sigurisë kombëtare.

5. Rasti Pricope kundër Rumanisë

(Nr. 60183/17)



Vendim gjyqësor i datës 30 maj 2023

Shtetet anëtare duhet të sigurojnë një ekuilibër të drejtë midis lirisë së shprehjes dhe të drejtës për mbrojtjen e reputacionit, duke garantuar që kritika ndaj figurave publike të mos penalizohet padrejtësisht.

Rasti Pricope kundër Rumanisë⁸ trajton një konflikt midis të drejtës për lirinë e shprehjes dhe mbrojtjes së reputacionit të individëve, duke e vënë theksin në rëndësinë e interesit publik.

Kërkuesi ishte gazetar dhe aktivist lokal, i cili publikoi deklarata kritike për aktivitetet e P.V. (biznesmen i njohur lokal), duke pretenduar se ky i fundit ishte përfshirë në praktika korruptive. Kërkuesi përmes shkrimeve të tij pretendonte se këto aktivitete kishin ndikuar negativisht në industrinë e automobilitave në zonën e tij, duke çuar në rënien e fabrikës vendase, e cila ishte një burim kyç i punësimit dhe i ekonomisë në atë rajon.

Si pasojë, P.V. ngriti padi për shpifje kundër kërkuesit, duke kërkuar kompenzim për dëmin që ai pretendonte se i ishte shkaktuar për dëmtim të reputacionit të tij personal dhe të imazhit të kompanisë.

Në përgjigjen në padi dhe përgjatë procedurës, Pricope shtjelloj të gjitha burimet në të cilat është bazuar dhe të cilat e kishin motivuar të shkruaj diçka të tillë. Ai theksoj gjithashtu se artikujt e publikuar nuk kishin të bënin me figurën e tij private, por vetëm me atë publike,

si dhe vuri në pah se në shkrimet e tij nuk kishte përdorur ndonjë fjalë ofenduese apo denigruese.

Megjithatë, fillimisht gjykata e shkallës së parë e hodhi poshtë padinë, duke theksuar se shprehjet e përdorura bien brenda kufijve të kritikës së lejuar për personat publik, kufij që janë më të gjerë në raport me individët e zakonshëm.

Ndërsa pas ankesës së P.V., gjykata e shkallës së dytë gjeti se gjykata më e ulët kishte dështuar të shqyrtonte të gjithë kontekstin faktik dhe t'i përgjigjej të gjitha pretendimeve të paraqitura para saj. Ajo e anuloi vendimin dhe e riktheu çështjen në rigjykim.

Më pas, gjykata e shkallës së parë e ndryshoi vendimin, duke vendosur në favor të P.V. dhe duke nxjerrë në pah se paditësi ka kontribuar në falimentimin e fabrikës nëpërmjet veprimtarive të paligjshme. Gjithashtu, gjykata konstatoj se shprehjet nënçmuese të përdorura për të përshkruar paditësin, cenojnë të drejtën e paditësit për dinjitet.

Sipas gjykatës, pavarësisht përdorimit të burimeve, gazetarët janë të detyruar të vërtetojnë saktësinë e burimit të informacionit. Po ashtu, gjykata potencoj se kërkuesi nuk mund të kërkojë mbrojtje nga neni 10 i Konventës si gazetar, sepse ai nuk e ka këtë status: *"ai është ekonomist dhe nuk ka studiuar gazetari, ndërsa gazetarët kanë një status të veçantë i cili përbëhet nga të drejta dhe detyrime që ata duhet të respektojnë kur publikojnë artikujt e tyre"*.

8 Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Rasti Pricope v. Romania, (Aplikimi nr. 60183/17), Strasburg, 30 Maj 2023.

Pas kësaj, kërkuesi i'u drejtua GjEDNJ-së përmes pretendimit se vendimet e gjykatës që e urdhëronin atë të paguante dëmshpërblim për artikujt që kishte shkruar për kompaninë dhe gjetjet e gjykatave vendase se ai nuk kishte të drejtë për mbrojtjen e ofruar për gazetarët, kishin shkelur të drejtën e tij për lirinë e shprehjes.

GjEDNJ shqyrtoi balancën midis të drejtës së Pricope për liri të shprehjes, të mbrojtur nga neni 10 i KEDNJ-së, dhe të drejtës së P.V.-së për mbrojtje nga shpifja dhe ruajtje të reputacionit, të garantuar nga neni 8⁹ i Konventës.

Gjykata vlerësoj se artikujt e kërkuesit kishin të bënin me një çështje me interes publik, veçanërisht me rënien e industrisë më të rëndësishme vendase dhe rolin që pretendohet se ka luajtur në këtë drejtim korrupsioni dhe menaxhimi i keq.

Si përfundim, GjEDNJ vlerësoj se vendimi i gjykatave kombëtare për të kufizuar lirinë e shprehjes së kërkuesit në lidhje me këtë rast nuk u mbështet nga arsye relevante dhe të mjaftueshme për qëllimet e testit të "domosdoshmërisë" sipas nenit 10.2 të Konventës¹⁰.

Rrjedhimisht, gjykata vendosi se dënimi i kërkuesit për shpifje nga gjykatat vendore është përcjellë me shkelje të nenit 10¹¹ të Konventës (Liria e shprehjes), meqenëse gjykatat kombëtare nuk kishin justifikuar në mënyrë adekuate kufizimin e të drejtës së Pricope për lirinë e shprehjes.

GJEDNJ konstatoi se gjykatat vendore kishin dështuar të balanconin si duhet të drejtën për lirinë e shprehjes me të drejtën për mbrojtjen e reputacionit. Ato kishin vendosur prioritet absolut ndaj reputacionit, duke injoruar dimensionin e interesit publik të deklaratave. Rrjedhimisht, Gjykata vuri në dukje se këto masa mund të krijojnë një efekt frenues për gazetarët dhe qytetarët që kërkojnë të raportojnë për çështje të ngjashme.



Pra, vendimi mbrojtje të drejtën e gazetarëve për të informuar publikun mbi çështje që lidhen me korrupsionin dhe ndikimet ekonomike, duke vendosur një precedent për mbrojtjen e lirisë së shprehjes në raste të ngjashme.

⁹ Çdokush ka të drejtën e respektimit të jetës së tij private dhe familjare, banesës dhe korrespondencës së tij.

¹⁰ Ushtrimi i lirisë që përmban detyrime dhe përgjegjësi, mund t'u nënshtrohet atyre formaliteteve, kushteve, kufizimeve ose sanksioneve të parashikuara me ligj dhe që janë të nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë kombëtare, integritetit territorial ose sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit dhe parandalimin e krimit, për mbrojtjen e shëndetit ose të moralit, për mbrojtjen e dinjitetit ose të të drejtave të të tjerëve, për të ndaluar përhapjen e të dhënave konfidenciale ose për të garantuar autoritetin dhe paanshmërinë e pushtetit gjyqësor.

¹¹ Çdokush ka të drejtën e lirisë së shprehjes. Kjo e drejtë përfshin lirinë e mendimit dhe lirinë për të marrë ose për të dhënë informacione dhe ide pa ndërhyrjen e autoriteteve publike dhe pa marrë parasysh kufijtë. Ky nen nuk i ndalon Shtetet që t'u kërkojnë ndërmarrjeve të transmetimit audioviziv, televiziv ose kinematografik të pajisen me liçencë.

6. Rasti Tërshana kundër Shqipërisë

(Nr. 48756/14)



Vendim gjyqësor i datës 04 nëntor 2020

Shtetet anëtare janë të obliguara për të siguruar hetime të plota, efektive dhe të paanshme në rastet e dhunës me bazë gjinore, si dhe të garantojnë qasje efektive në drejtësi për viktimat, duke u dhënë atyre të drejtën për të apeluar vendimet e autoriteteve hetimore. Në të kundërtën, kjo paraqet shkelje të nenit 2 të KEDNj-së (e drejta për jetën)¹² nga pikëpamja procedurale.

Në çështjen *Tërshana kundër Shqipërisë*¹³, GjEDNJ vuri në pah detyrimin e shtetit për të mbrojtur individët nga dhuna me bazë gjinore dhe për të siguruar një hetim të plotë dhe efektiv ndaj autorëve të këtyre krimeve.

Në këtë çështje bëhet fjalë për një sulm serioz mbi paditësen në vitin 2009 në Tiranë, kur një person i panjohur e sulmoi duke i hedhur acid dhe duke i djegur një pjesë të madhe të trupit. Nga dëmtimet e rënda të pësuar nga ky sulm, paditësja kishte humbur aftësinë për punë për disa vite me radhë.

Paditësja vazhdimisht kishte hedhur dyshime se sulmin e kishte kryer ish-bashkëshorti i saj, për shkak të hak-marrjes ndaj saj, si dhe të kaluarës së tij me kërcënime për vrasje dhe dhunë të vazhdueshme. Gjithashtu, paditësja kishte dëshmuar se ish-bashkëshorti kishte të kaluar kriminale të evidentuar, si dhe posedonte armë.

Ndonëse paditësja kishte paraqitur edhe dëshmi të tjera që sugjeronin lidhje të drejtpërdrejta të sulmit me ish-bashkëshortin, autoritetet shtetërore nuk arritën të mbledhin prova të mjaftueshme për të mundësuar identifikimin e autorit të këtij sulmi.

Rrjedhimisht, me 2 shkurt 2010 prokuroria me një vendim të arsyetuar, vendosi të pezullojë hetimin në lidhje me veprën në fjalë, për veprime të mëtijshme për identifikimin e autorit. Vendimi përshkruante të gjitha provat e marra dhe deklaratat e dhëna nga ankuesja dhe personat e tjerë, si dhe se autori i sulmit nuk mund të identifikohet. Në anën tjetër, paditësja nuk kishte marrë asnjë komunikim tjetër zyrtar pas fillimit të hetimit nga ana e prokurorisë, si dhe nuk e kishte pranuar vendimin për pezullim të hetimit. Gjithsesi, edhe po ta kishte pranuar vendimin e tillë, ndaj vendimeve të prokurorisë nuk ishte e lejuar e drejta e ankesës.

Gjithashtu, paditësja parashtroj edhe padi për dëmshpërblim ndaj Ministrisë së Drejtësisë, duke kërkuar dëmshpërblim nga shteti si pasojë e sulmit të pësuar, si dhe që të lirohet nga pagesa e taksave gjyqësore për shkak të mungesës së mjeteve financiare dhe të përcaktohet masa e dëmshpërblimit nga ekspertët. Mirëpo, për shkak se e kishte të pamundur të paguante tarifat gjyqësore, ajo ishte tërhequr nga padia e saj.

¹² E drejta e çdo njeriu për jetën mbrohet me ligj. Askujt nuk mund t'i merret jeta qëllimisht, me përjashtim të rastit kur zbatohet një vendim gjyqësor me vdekje, pas dënimit për një krim për të cilin ky dënim është parashikuar me ligj.

¹³ Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Rasti Tërshana kundër Shqipërisë, nr. 48756/14, Vendim gjyqësor i datës 04 nëntor 2020.

Me pretendimet se autoritetet nuk kishin mbrojtur jetën e saj dhe të drejtën e saj për respektimin e jetës së saj private sipas neneve 2¹⁴, 3¹⁵, 8¹⁶, 13¹⁷ dhe 14¹⁸ të KEDNJ-së, kërkuesja i'u drejtua GjEDNJ-së.

Rrjedhimisht, GjEDNJ në vendimin e saj konstatoj se Shqipëria nuk ishte përgjegjëse për sulmin në vetvete, por për mungesën e një hetimi të plotë dhe efektiv. Pra GjEDNJ gjeti se autoritetet shqiptare nuk janë përgjegjëse për shkeljen e nenit 2 nga pikëpamja materiale e saj, por për shkeljen e këtij neni nga pikëpamja procedurale, duke pasur parasysh natyrën e veprës në fjalë, pra të dhunës me bazë gjinore. Pra vendimi vuri në pah moskryerjen me shpejtësinë dhe vendosmërinë e duhur të masave hetimore, si dhe pamundësinë e ankueses për të apeluar vendimin për pezullimin e hetimit.

Rrjedhimisht, mungesa e një hetimi të plotë dhe efektiv nga autoritetet shqiptare ishte konsideruar si shkelje e të drejtës për jetë, për shkak të pasojave që ka ky dështim për viktimat e dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore.

Vendimi gjithashtu thekson nevojën për kujdes të shtuar në rastet që përfshijnë dhunë në familje dhe rëndësinë e një reagimi efektiv për të parandaluar mos-ndëshkimin e autorëve të këtyre akteve.



Ky rast nënvizon qëndrimin e GjEDNJ-së mbi rastet kur shtetet nuk arrijnë të kryejnë detyrimet ligjore për të ndërmarrë veprimet dhe masat adekuate në drejtim të mbrojtjes të së drejtës për jetë përmes hetimeve efektive dhe masave mbrojtëse, me qëllim të forcimit të kuadrit mbrojtës për viktimat e dhunës në familje dhe atyre me bazë gjinore.

14 E drejta e çdo njeriu për jetën mbrohet me ligj. Askujt nuk mund t'i merret jeta qëllimisht, me përjashtim të rastit kur zbatohet një vendim gjyqësor me vdekje, pas dënimit për një krim për të cilin ky dënim është parashikuar me ligj.

15 Askush nuk mund t'i nënshtrohet torturës ose dënimeve ose trajtimeve çnjerëzore ose poshtëruese

16 Çdokush ka të drejtën e respektimit të jetës së tij private dhe familjare, banesës dhe korrespondencës së tij.

17 Çdokush, të cilit i janë shkelur të drejtat dhe liritë e përcaktuara në këtë Konventë, ka të drejtën e një zgjidhjeje efektive para një organi kombëtar, pavarësisht se shkelja është kryer nga persona që veprojnë në përmbushje të funksioneve të tyre zyrtare.

18 Gëzimi i të drejtave dhe i lirive të përcaktuara në këtë Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo status tjetër.

7. Rasti Simonova kundër Bullgarisë

(Nr. 30782/16)



Vendimi gjyqësor i datës 11 prill 2023

Shtetet anëtare obligohen për të balancuar interesin publik me të drejtat individuale, veçanërisht kur bëhet fjalë për prishjen e ndërtimeve pa leje që përfshijnë familje me fëmijë të mitur. Në rastet e tilla, shtetet duhet të ndërmarrin hapa konkretë për të shmangur pasojat e rënda sociale që rrjedhin nga vendime të tilla, duke siguruar që çdo ndërhyrje të jetë proporcionale dhe të marrë parasysh rrethanat individuale të të prekurve. Në të kundërtën, veprimet e tilla paraqesin shkelje të nenit 8 të KEDNj-së (E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare).¹⁹

Në çështjen “Simonova kundër Bullgarisë”²⁰ GjEDNJ trajton çështjen e prishjes së ndërtimeve pa leje dhe të drejtën për respektimin e banesës sipas nenit 8 të KEDNj-së.

Kërkuesja, Simonova, është shtetase bullgare dhe nënë e shtatë fëmijëve të mitur. Në vitin 2008 ajo bleu një truall dhe tokë bujqësore, dhe pas ndërtimit ajo dhe fëmijët e saj filluan të jetonin aty. Ndërtesa nuk kishte instalime elektrike, furnizim me ujë, apo kanalizime.

Në mars 2015, pas një mosmarrëveshjeje për kufirin me pronarin e truallit fqinj, autoritetet vendore lëshuan një urdhrë për prishjen e ndërtesës, duke argumentuar se ishte ndërtuar pothuajse tërësisht në truallin fqinj dhe

se ishte e paligjshme, pasi nuk kishte certifikatë përputhshmërie me rregulloret e ndërtimit dhe përdorej për banim në vend të qëllimeve bujqësore.

Pas diskutimeve për mundësitë e strehimit alternativ për kërkuesen dhe fëmijët e saj, ajo refuzoj ndihmën e shërbimeve sociale dhe deklaroi se do të transferoheshin tek të afërmit. Ekzekutimi i urdhrin të prishjes u shtye deri në nëntor 2017, kur çatia dhe një nga muret e shtëpisë u prishën. Ndërkaq më vonë, kërkuesja Simonova rindërtoj ndërtesën dhe vazhdoi të jetonte aty.

Gjykata Administrative vendore dhe më pas Gjykata e Apelit miratuan urdhrin për prishje, duke deklaruar se ndërtimi ishte në kundërshtim me rregullat e urbanizmit dhe me kushtet e përcaktuara në lejen e ndërtimit. Ndër të tjera, gjykata theksoj se nuk kishte prova që ndërtesa të mund të legalizohej, pasi ajo nuk përmbushte kriteret e nevojshme dhe se interesi publik për respektimin e rregullave të ndërtimit mbisundonte interesat personale të kërkueses.

Gjithashtu, gjykatat vendore pranuan se prishja e ndërtesës do ta linte familjen pa strehë, por theksuan se kërkuesja kishte pasur mundësi të aplikonte për ndihmë sociale ose strehim alternativ, të cilën ajo e kishte refuzuar. Gjykatat gjithashtu potencuan se situata sociale nuk e justifikonte që ajo të qëndronte në një ndërtesë të ndërtuar në mënyrë të paligjshme.

Kërkuesja më pas u ankua në GjEDNJ se urdhri i marsit 2015 për prishjen e ndërtesës në të cilën ajo jetonte me fëmijët e saj kishte ndërhyrë në mënyrë disproporcio-

¹⁹ Autoriteti publik nuk mund të ndërhyjë në ushtrimin e kësaj të drejte, përveçse në shkallën e parashikuar nga ligji dhe kur është e nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit publik, shëndetit ose moralit ose për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të të tjerëve

²⁰ Gjykata Evropian për të Drejtat e Njeriut, Rasti Simonova kundër Bullgarisë (Kërkesa nr. 30782/16), 11 prill 2023.

nale me të drejtën e saj për respektimin e shtëpisë së saj, mbështetur në nenin 8 të KEDNJ-së.

GjEDNJ konstatoi se ndërhyrja në të drejtën e kërkuësës për respektimin e banesës së saj ishte në përputhje me ligjin dhe ndiqte një qëllim legjitim. Megjithatë, autoritetet kombëtare nuk arritën të vendosin një ekuilibër të drejtë ndërmjet interesit publik dhe të drejtës së individit për respektimin e banesës, veçanërisht duke pasur parasysh se prishja do të linte një familje me fëmijë të mitur pa strehë.

Sipas GjEDNJ-së, autoritetet nuk morën parasysh të gjithë faktorët relevantë dhe nuk ofruan zgjidhje adekuate për strehimin e kërkuësës dhe fëmijëve të saj. Sipas saj, shembja nuk ishte e nevojshme në një shoqëri demokratike dhe, rrjedhimisht, gjeti shkelje të nenit 8 të KEDNJ-së, sepse autoritetet bullgare nuk morën parasysh rrethanat individuale të kërkuësës dhe nuk kryen një vlerësim proporcionaliteti të ndërhyrjes në të drejtën e kërkuësës për respektimin e banesës së saj.

Sipas GjEDNJ-së, vetë urdhri i prishjes nuk përmbante ndonjë analizë nëse do të ndikonte në mënyrë disproporcionale tek kërkuësja në dritën e rrethanave të saj të veçanta. Gjithashtu, nuk ka asnjë provë që, gjatë lëshimit të urdhrit, autoriteti kompetent u përpoq të peshonte qëllimin e ndjekur nga urdhri i tij me rrethanat individuale të kërkuësës.

Sipas GjEDNJ-së, autoritetet vendore do të duhej të kishin konsideratë për rrezikun që një familje e përbërë nga të paktën katër fëmijë të mitur të mbetet e pastrehë, si dhe se një veprim i tillë do të duhej të shoqërohej me hapa që synojnë të lehtësojnë siç duhet vështirësitë serioze që rrjedhin prej tij, për shembull, hapa të vërtetë nga autoritetet sociale ose të tjera që synojnë të sigurojnë që kërkuësi dhe fëmijët e saj do të jenë në gjendje të gjejnë menjëherë strehim alternativ të përshatshëm.

Pra, autoritetet nuk i ofruan kërkuësës një zgjidhje të plotë, sepse propozimi i vetëm që u bë nënkuptonte vendosjen e përkohshme të fëmijëve të saj në strehim të menaxhuar nga shërbimet sociale. Vonesa në zbatimin e urdhrit të shembjes, ndonëse pa dyshim që i dha kërkuësës një afat kohor të caktuar, nuk çoi drejt një zgjidhjeje të duhur të problemit me të cilin ajo po përballlej.



Ky rast nënvizon detyrimin e autoriteteve kombëtare për të balancuar interesin publik me të drejtat individuale, veçanërisht në situata që përfshijnë familje me fëmijë të mitur dhe rrezikun e mbetjes pa strehë si rezultat i prishjes së ndërtimeve pa leje.

8. Rasti Bagirova dhe të tjerët kundër Azerbajxhanit (Nr. 37706/17 dhe të tjerat)



Vendimi gjyqësor i datës 31 gusht 2023

Shtetet anëtare kanë detyrimin të ndjekin procedurat e parashikuara me ligj gjatë shpronësimit të pronave private dhe të sigurojnë që ndërhyrjet në të drejtat pronësore të jenë të bazuara në ligj dhe të jenë proporcionale me qëllimin e ndjekur. Nëse këto procedura nuk respektohen, ndërhyrjet e tilla përbëjnë shkelje të nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së²¹ (e drejta e pronës), duke cenuar parimin e sigurisë juridike dhe mbrojtjen e pronës private.

Rasti Bagirova dhe të tjerët kundër Azerbajxhanit²² i GjEDNJ-së trajton rastin e gjashtë shtetasve Azerbajxhanas që kishin prona (shtëpi private, pjesë të shtëpive ose apartamenteve) në një zonë ku autoritetet kombëtare synonin të implementonin një projekt për përmirësimin e infrastrukturës së qarkullimit rrugor.

Për këtë qëllim, në vitin 2013, autoritetet kombëtare nxorën një urdhër për lirim dhe shembjen e pronave që ishin në atë zonë, të cilat duhej të bliheshin sipas kontratave të shitjes (të lidhura në baza vullnetare).

Në vitin 2015, Kabineti i Ministrave miratoi një urdhër për shpronësimin e këtyre pronave për nevojat e shtetit, veçanërisht për qëllimin e ndërtimit të rrugëve dhe rrjeteve të tjera të komunikacionit. Pronat e kërkuarve u prishën në data të ndryshme në vitet 2015-2016. Pas prishjes, disa nga kërkuarët lidhën kontrata shitblerjeje dhe morën kompensim sipas vlerësimeve të bëra nga një vlerësues privat i kontraktuar nga autoritetet shtetërore.

Në një sërë procesesh gjyqësore (përfshirë disa të filluara nga kërkuarët që kishin lidhur kontrata shitblerjeje për të kërkuar shfuqizimin e tyre), gjykatat e brendshme urdhëruan shpronësimin e kërkuarve kundrejt kompensimit. Kërkuarët përgjatë proceseve gjyqësore argumentuan se nuk kishte pasur nevojë shteti për shpronësimin e pronave të tyre pasi rrugët që do të përmirësoheshin në atë zonë kishin vetëm rëndësi lokale. Ata më tej argumentuan se vendimi i Kabinetit të Ministrave i vitit 2015 kishte dështuar të specifikonte nevojën e shtetit në fjalë dhe se ai i ishte referuar Planit të Përgjithshëm të Zhvillimit të Qytetit i cili kishte mbuluar periudhën deri në vitin 2005 dhe për këtë arsye nuk kishte qenë më në fuqi në kohën e ngjarjeve në fjalë.

Kërkuarët argumentuan më tej se caktimi i një komisioni vlerësimi dhe i një vlerësuesi të pavarur mund të ishte bërë vetëm pas një vendimi të miratuar nga Kabineti i Ministrave. Ata kundërshtuan gjithashtu shumat e ofruara ose të paguara për ta, me argumentin se ato nuk kishin qenë në përputhje me vlerën e tregut të pronave të tyre.

21 Çdo person fizik ose juridik ka të drejtën e gëzimit paqësor të pasurisë së tij. Askush nuk mund të privohet nga prona e tij, përveçse për arsye të interesit publik dhe në kushtet e parashikuara nga ligji dhe nga parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare.

22 Gjykata Evropian për të Drejtat e Njeriut, Rasti Bagirova dhe të tjerët kundër Azerbajxhanit (Kërkesa nr. 37706/17 dhe të tjerat), Vendimi gjyqësor i datës 31 gusht 2023.

Për sa i përket kontratave të shitblerjes, kërkuessit argumentuan se nuk kishin zgjidhje tjetër veçse t'i nënshkruanin ato, sepse kushtet e jetesës, si rezultat i punimeve të prishjes që po ndodhnin rreth tyre dhe shkurtimeve të shpeshta në ofrimin e shërbimeve komunale, ishin bërë shumë të vështira.

Gjykatat kombëtare hodhën poshtë të gjitha pretendimet e kërkuessve, duke konstatuar se shpronësimi i pronave të ankuesve në këmbim të kompensimit të propozuar ishte në përputhje me kërkesat sipas ligjit të brendshëm dhe se shumat e ofruara ose paguara atyre sipas kontratave të shitblerjes kishin qenë të përshatshme. Gjykatat vlerësuan se ato kontrata ishin lidhur vullnetarisht dhe në përputhje me dispozitat e ligjit të brendshëm dhe se ankuesit nuk kishin paraqitur asnjë provë për të kundërtën.

Me pretendimet se ka pasur shkelje të nenit 1 të Prot. 1 të KEDNJ-së, kërkuessit i'u drejtuan GjEDNJ-së. Pas shqyrtimit, GjEDNJ vendosi se urdhri i shpronësimit dhe shembja e pronave të kërkuessve përbënte ndërhyrje në të drejtën e tyre për pronën sipas nenit 1 të Prot. nr. 1 të KEDNJ-së.

Sipas GjEDNJ-së, autoritetet kombëtare nuk ndoqën procedurën e brendshme për shpronësimin e pronës private për nevoja të shtetit. Vendimi i Kabinetit të Ministrave i datës 11 nëntor 2015 kishte të bënte vetëm me fazën përgatitore të procedurës së shpronësimit dhe se nuk u ndërmor asnjë nga hapat e mëvonshëm procedural të parashikuar nga legjislacioni kombëtar. Në veçanti, Kabineti i Ministrave nuk kishte nxjerrë asnjëherë një vendim për shpronësimin dhe për përfshirjen e një vlerësuesi të pavarur, i cili në fakt ishte përfshirë në procedurë pa një vendim të tillë.

GjEDNJ rithekson se kërkesa e parë dhe më e rëndësishme e nenit 1 të Protokollit nr. 1 është që çdo ndërhyrje nga një autoritet publik në gëzimin paqësor të zotërimeve duhet të jetë e ligjshme. Rrjedhimisht, vlerësimet e mësipërme janë të mjaftueshme për të konstatuar se procedura e brendshme për shpronësimin e pronës private nuk është ndjekur në rastet në fjalë. Prandaj, ndërhyrja në gëzimin paqësor të zotërimeve të kërkuessve nuk është kryer në përputhje me "kushtet e parashikuara me ligj".

Nisur nga sa u shpalos më sipër, GjEDNJ konstaton se autoritetet e Azerbajxhanit kanë shkelur nenin 1, Prot. nr. 1 të KEDNJ-së, sepse mungonte baza ligjore për ndërhyrjen në shfrytëzimin e qetë të kërkuessve mbi pronat e tyre.



Ky vendim nënvizon detyrimin e autoriteteve kombëtare për të ndjekur procedurat e parashikuara me ligj gjatë shpronësimit të pronave private dhe për të siguruar që ndërhyrjet në të drejtat pronësore të jenë të bazuara në ligj dhe të jenë proporcionale me qëllimin e ndjekur.

9. Rasti Macatë kundër Lituanisë

(Nr. 61435/19)



Vendim gjyqësor i datës 23 janar 2023

Gjykata konstatoi se kufizimi i qasjes së fëmijëve në literaturën që trajton marrëdhëniet e të njëjtit seks është i papajtueshëm me nocionet e barazisë, pluralizmit dhe tolerancës në një shoqëri demokratike. Ajo theksoi gjithashtu se kufizime të tilla mund të kontribuojnë në përhapjen e stereotipeve dhe diskriminimit ndaj komunitetit LGBTI+.

Rasti Macatë kundër Lituanisë²³ trajton një çështje që lidhet me të drejtat e komunitetit LGBTI+, duke nxjerrë në pah sfidat për të balancuar lirinë individuale të shprehjes me ndikimin e mundshëm të disa përmbajtjeve mbi zhvillimin dhe mirëqenien e fëmijëve.

Kërkuesja ishte shkrimtare lituaneze, e cila në dhjetor 2013 publikoi një libër për fëmijë të titulluar "Zemra prej qelqi", i cili përmbante gjashtë përralla. Libri u botua nga Universiteti Lituanëz i Shkencave Arsimore, me financim të pjesshëm nga Ministria e Kulturës. Libri, i cili u drejtohej fëmijëve nëntë/dhjetë vjeç, përmbante një përshtatje të përrallave tradicionale. Dy nga gjashtë përrallat në libër kishin histori për marrëdhëniet dhe martesat mes personave të të njëjtit seks.

Në mars të vitit 2014, Ministria e Kulturës inicioi një ankesë me pretendimin se libri "inkurajonte perversitetet". Ministria kërkoi nga autoriteti kompetent që të vlerësojë nëse libri mund të jetë i dëmshëm për fëmijët. Në të njëjtën kohë, pas një letre të dërguar nga tetë anëtarë të Parlamentit Lituanëz, Universiteti pezulloi shpërndarjen e librit.

Në prill, vlerësimi doli në përfundim se dy përrallat e kontestuar nuk ishin në përputhje me një dispozitë kombëtare sipas së cilës çdo informacion që "shpreh përbuzje për vlerat familjare" ose "nxit një koncept të ndryshëm të martesës dhe krijimit të familjes nga ai i parashikuar në Kushtetutë ose Kodi Civil" konsiderohet me efekt negativ për të miturit.

Autoriteti rekomandoi që libri të etiketohej me një paralajmërim se mund të ishte i dëmshëm për fëmijët nën 14 vjeç. Rrjedhimisht, në vitin 2015 rifilloi shpërndarja e librit që kishte etiketën paralajmëruese, ndërsa kërkuesja inicioi kontest civil kundër Universitetit, duke argumentuar se përshkrimi i marrëdhënieve të të njëjtit seks nuk mund të konsiderohet i dëmshëm për fëmijët e çfarëdo moshe.

Në fund, gjykatat lituaneze rrëzuan pretendimin e saj, duke mbështetur vendimet e autoriteteve dhe duke gjetur se libri mund t'u shkaktonte dëm fëmijëve, disa mesazhe ishin shumë të detajuara në aspektin seksual dhe mënyra në të cilën përrallat përshkruanin një model të ri familjar ngritën pyetjen nëse librat me përralla për fëmijë që përshkruajnë marrëdhëniet e të njëjtit seks janë mënyra për të shprehur mendimin e dikujt dhe për të dhënë informacion.

23 Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Rasti Mocate kundër Lituanisë, (nr. 61435/19), Vendim gjyqësor i datës 23 janar 2023.

Më pas, kërkuesja i'u drejtua GjEDNj-së, duke pretenduar shkelje të nenit 10 (liria e shprehjes) dhe nenit 14 (ndalimi i diskriminimit) të KEDNj-së.

Pa shqyrtimit, GjEDNj konstaton se masat e kundërshtuara përbënin një ndërhyrje në ushtrimin e lirisë së shprehjes së kërkueses, të mbrojtur nga neni 10 i KEDNj-së. Gjykata konstaton se masat kundër librit të autorit synonin të kufizonin qasjen e fëmijëve në informacionet që paraqisnin marrëdhëniet e të njëjtit seks si të barasvlershme me ato të seksit të kundërt.

Gjykata konstaton se nuk kishte prova shkencore që sugjeronin se përmbajtja e homoseksualitetit ose debatet publike mbi statusin e minoriteteve seksuale do të kishin efekt negativ tek fëmijët. Për më tepër, sipas gjykatës, kufizimi i qasjes së fëmijëve në informacionet mbi marrëdhëniet e të njëjtit seks kontribuon në stigmatizimin e vazhdueshëm dhe është i papajtueshëm me nocionet e barazisë, pluralizmit dhe tolerancës në një shoqëri demokratike.



Ky ishte rasti i parë në të cilin GjEDNj ka vlerësuar kufizimet mbi literaturën që trajton marrëdhëniet e të njëjtit seks, të shkruara posaçërisht për fëmijët. Vendimi thekson rëndësinë e lirisë së shprehjes dhe mbrojtjen kundër diskriminimit bazuar në orientimin seksual, veçanërisht në kontekstin e edukimit dhe informimit të fëmijëve.

10. Rasti Zorina International SRL kundër rumanisë (Nr. 15553/15)



Vendimi gjyqësor i datës 27 qershor 2023

Shtetet anëtare kanë të drejtën të vendosin masa për kontrollin e përdorimit të pronës në kuadër të politikave fiskale, përfshirë sanksionet ndaj bizneseve që shkelin rregullat tatimore. Nëse këto masa janë të parashikuara me ligj, ndjekin një qëllim legjitim, shoqërohen nga procese të drejta të rishikimit gjyqësor dhe janë proporcionale me rëndësinë e shkeljes, atëherë ato nuk përbëjnë shkelje të nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNj-së (e drejta e pronës).

Rasti Zorina International SRL kundër Rumanisë²⁴, trajton çështjen që lidhet me masat administrative të marra nga autoritetet romune ndaj një shoqërie tregtare për shkelje të rregullave fiskale, duke ngritur çështje që ndërlidhen me të drejtën për respektimin e pronës, sipas nenit 1 të Prot.1 të KEDNj-së.

Kompania kërkuese është një shoqëri tregtare me seli në Rumani. Në mars 2013, pas një inspektimi, autoriteti tatimor raportoi se shoqëria tregtare në fjalë nuk kishte lëshuar fatura për shumën prej 179 RON (afërsisht 40 Euro), dhe se përfaqësuesi i shoqërisë, i cili ishte i pranishëm, gjatë inspektimit nuk kishte dhënë asnjë shpjegim në lidhje me këtë.

Në lidhje me këtë, shoqëria tregtare u dënua me gjobë në shumën 8.000 RON (afërsisht 1.900 euro) dhe shuma prej 179 RON (afërsisht 40 Euro) u konfiskua; gjithashtu, aktivitetet e shoqërisë u pezulluan për një periudhë tre mujore.

Kompania kërkuese i'u drejtua gjykatave vendore, me pretendimet se sanksionet e vendosura ndaj saj kishin rrezikuar seriozisht aktivitetet e saj tregtare, të cilat bazoheshin kryesisht në shitjen e mallrave që prishen (ushqime dhe të ngjashme). Së pari, ajo argumentoi se shuma prej 179 RON nuk përfaqësonte vlerën e mallrave që ishin shitur, por ishin para të mbajtura në arkë për t'i mundësuar asaj që të kishte këmbim të mjaftueshëm në dispozicion për klientët.

Rrjedhimisht, kompania kërkuese kërkoi që raporti i autoritetit tatimor dhe si rrjedhim sanksionet, të shpallehin të pavlefshme. Në alternativë, ajo parashitroi se "sanksioni" i shqiptuar kishte qenë në mënyrë disproporcionale i ashpër në lidhje me shumën që u konstatua si e pa llogaritur dhe kërkoi që gjoba të zëvendësohej me ndonjë paralajmërim. Ajo argumentoi se shuma e gjobës kishte qenë e tepruar, duke pasur parasysh natyrën e aktiviteteve të kompanisë, dhe se, në fund të fundit, pezullimi i aktiviteteve të saj për tre muaj kishte qenë në vetvete mjaft i mundimshëm për t'i shërbyer qëllimit të synuar.

²⁴ Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Zorina International SRL kundër Rumanisë (Kërkesa nr. 15553/15), Vendimi gjyqësor i datës 27 qershor 2023

Shoqëria kërkuese gjithashtu pretendoi se ndërmjet viteve 2009 dhe 2014 autoriteti tatimor kishte inspektuar aktivitetet e tij tridhjetë e gjashtë herë dhe nuk kishte gjetur ndonjë parregullsi, përveç një rasti të paraqitur në kërkesën aktuale.

Më 7 tetor 2013 gjykata rrëzoi padinë e shoqërisë ankuese. Ajo konstatoi se pretendimet e saj lidhur me arsyen se përse ishte gjetur në arkë shuma prej 179 RON nuk mund të vërtetoheshin, përderisa raporti i organit tatimor ishte nënshkruar si i tillë nga përfaqësuesi i shoqërisë, i cili në atë kohë nuk kishte qenë në gjendje të jepte ndonjë shpjegim për paratë në fjalë.

Gjykata vlerësoi më tej se të dyja sanksionet e vendosura në raportin e autoritetit tatimor ishin të drejta dhe proporcionale, duke pasur parasysh faktin se gjoba e vendosur përfaqësonte shumën minimale të përcaktuar me ligj.

Shoqëria kërkuese u ankua kundër vendimit të 7 tetorit 2013, duke përsëritur argumentet e saj të mëparshme. Mirëpo, edhe gjykata e shkallës së dytë hodhi poshtë ankesën dhe la në fuqi vendimin e gjykatës më të ulët. Gjykata u shpreh se roli i sanksioneve të kundërshtuara ishte parandalues dhe edukativ në natyrë, dhe jo një dëmshpërblim. Sipas kësaj gjykate, legjislativi kishte zgjedhur të penalizonte akte të tilla si ajo e kryer nga kompania kërkuese duke vendosur gjoba të larta, pikërisht sepse statistikave zyrtare zbuluan një rritje të dukshme të kundërvajtjeve tatimore.

Kompania kërkuese u ankua në GjEDNJ se sanksionet e vendosura ndaj saj për dështimin në lëshimin e faturave ishin joproporcionale dhe si rrjedhim nuk kishin një ekuilibër të drejtë midis interesit publik dhe të drejtave të saj pronësore, siç parashikohet në nenin 1 të Prot. nr. 1.

Pas shqyrtimit të çështjes, GjEDNJ vendosi se ndërhyrja në të drejtat e pronës së kërkuesit përfshihet në kuadër të masave për "kontrollin e përdorimit të pronës", dhe më konkretisht, në lidhje me gjobën, masa "për sigurimin e pagesës së taksave apo kontributeve apo gjobave të tjera", sipas objektit të nenit 1 të Prot. nr. 1 të KEDNJ-së. Sanksionet kumulative të vendosura ndaj kërkuesit ishin parashikuar me ligj dhe ndiqnin qëllimin legjitim për të luftuar evazionin fiskal dhe për të përmirësuar përgjegjësinë financiare mes tregtarëve.

Pas shqyrtimit, GjEDNJ konsideroj se sanksionet e vendosura ndaj kërkuesit lidheshin me politikën fiskale të Rumanisë, e cila u përpoq të inkurajonte më shumë disiplinë dhe përgjegjësi në fushën e biznesit dhe të kontabilitetit. Për më tepër, kërkuesi i'u drejtua proceseve të drejta të rishikimit gjyqësor. Gjykatat e brendshme i lanë në fuqi sanksionet duke i konsideruar në proporcion me një qëllim të tillë. Kjo ndërhyrje është legjitime nëse parashikohet në të drejtën kombëtare, bëhet për qëllim të goditjes së evazionit tatimor (sidomos kur paraqet një problem të përsëritur në nivel kombëtar), shoqërohet nga procese të drejta të rishikimit gjyqësor përpara gjykatave të brendshme, dhe nëse sanksioni është proporcional me rëndësinë e veprës penale (p.sh., pezullimi i përkohshëm i veprimtarive tregtare).

Në këto rrethana, GjEDNJ vlerësoi se nuk ka shkelje të nenit 1, Prot., nr. 1 (Mbrotja e pronës) të KEDNJ-së, duke arsyetuar se autoritetet kombëtare kishin vendosur një ekuilibër të drejtë ndërmjet interesit të përgjithshëm dhe respektimit të së drejtës së pronës së shoqërisë kërkuese.



Ky vendim nënvizon se vendosja e sanksioneve që lidhen me evazionin tatimor përbën ndërhyrje në të drejtën e pronës, e cila është legjitime nëse parashihet në të drejtën kombëtare, ndjek një qëllim legjitim, shoqërohet nga procese të drejta të rishikimit gjyqësor dhe është proporcionale me rëndësinë e veprës penale.

11. Rasti Yordanov dhe të tjerët kundër Bullgarisë

(Nr. 265/17 dhe 26473/18)



Vendimi gjyqësor i datës 26 shtator 2023

Shtetet anëtare nuk mund të konfiskojnë pasuri thjesht mbi bazën e mungesës së provave për origjinën e ligjshme të tyre, pa vendosur një lidhje të qartë me një veprë të paligjshme. Masat për sekuestrimin e pasurive duhet të respektojnë standardet e proporcionalitetit dhe të drejtës për një proces të rregullt. Përndryshe, veprimet e tilla përbëjnë shkelje të nenit 1 të Prot. nr. 1 të KEDNJ-së (e drejta e pronës).

Çështja “Yordanov dhe të tjerët kundër Bullgarisë”²⁵, trajton konfiskimin e pasurive të përfituara në mënyrë të paligjshme, legjitimitetin e kësaj mase dhe ndikimin e saj në të drejtat pronësore, të parapara në KEDNJ.

Në vitin 2012, Bullgaria miratoi Ligjin për Sekuestrimin e Pasurive të Përfituara në mënyrë të Paligjshme, i cili parashikonte sekuestrimin e pasurive për të cilat nuk është përcaktuar origjina e ligjshme. Ky ligj e shkëputi sekuestrimin nga çdo proces penal, duke mundësuar nisjen e procedurave edhe nëse personi i prekur kishte kryer veprimtari të paspecifikuara kriminale ose të paligjshme. Ligji i vitit 2012 zëvendësoi Ligjin e vitit 2005 për sekuestrimin e të ardhurave nga krimi, i cili kërkonte një dënim penal dhe një lidhje të drejtpërdrejtë midis veprës së kryer dhe pasurisë që do të konfiskohej.

Kërkuesit në këtë rast ishin tre shtetas bullgarë (dy banonin në Bullgari dhe një në Belgjikë) si dhe një shoqëri tregtare me seli në Bullgari. Ata ishin dënuar për vepra të lidhura me shmangien e tatimeve dhe përdorimin e dokumenteve të falsifikuara, vepra këto të kryera nga viti 2005 deri në vitin 2013.

Gjithashtu, gjykatat bullgare urdhëruan sekuestrimin e pasurive të tyre bazuar në Ligjin për Sekuestrimin e Pasurisë, të vitit 2012, duke arritur në përfundimin se kërkuesit nuk kishin arritur të provojnë burimin e ligjshëm të pasurive të tyre. Pas përfundimit të procedurës së sekuestrimit, një pjesë e pasurive të sekuestruara u nxorën në shitje publike dhe i'u shitën të tretëve. Megjithatë, lidhja ndërmjet veprës penale të kryer dhe pasurive që do të konfiskoheshin asnjëherë nuk u provua. Sipas gjykatave bullgare, kjo lidhje nuk kërkohej sipas ligjit të vitit 2012, pasi kjo pjesë e legjislacionit kishte të bënte me të gjitha pasuritë e fituara në mënyrë të paligjshme dhe jo domosdoshmërisht me të ardhurat nga krimi.

Pas shqyrtimit të kësaj çështjeje, GjEDNJ vlerësoj se sekuestrimi i pasurive të kërkuesve përbënte ndërhyrje në të drejtat e tyre sipas nenit 1, Prot. nr. 1 të KEDNJ-së. Ndërhyrja e kishte një bazë në të drejtën e brendshme (Ligji 2012) dhe ndiqte një qëllim legjitim në interesin publik, pra parandalimin e fitimit të paligjshëm të pronës përmes veprave penale ose administrative. Në kryerjen e vlerësimit të proporcionalitetit të ndërhyrjes, gjykata gjeti se ligji i vitit 2012 ruajti një numër të konsiderueshëm mangësish që kishte ligji i vitit 2005, duke

përfshirë fushën e tij shumë të gjerë të zbatimit (p.sh., një listë të gjerë veprash për të cilat mund iniciohen procedurat e sekuestrimit) dhe zbatimin e tij me fuqi prapavepruese (ligji i vitit 2012 zbatohet për veprat penale të kryera vite përpara hyrjes në fuqi, siç ka ndodhur në lidhje me një nga kërkesat).

Nëse legjislacioni i brendshëm autorizon sekuestrimin e pasurive "të fituara në mënyrë të paligjshme" (d.m.th, pasuri për të cilat nuk është përcaktuar origjina e ligjshme), gjykatat e brendshme duhet të përcaktojnë një lidhje ndërmjet veprës (penale ose administrative) që ka gjeneruar paratë për të blerë pasuritë, nga njëra anë, dhe pasurive si objekt sekuestrimi, nga ana tjetër. Mosveprimi në këtë mënyrë përbën shkelje të nenit 1 të Prot. nr 1 të KEDNj -së.

Këto mangësi e bënë të vështirë për kërkuesit detyrën për të provuar burimin e ligjshëm të të ardhurave ose origjinës së çdo pasurie.

Në veçanti, GjEDNj përsëriti se një sekuestrim sipas ligjit të vitit 2012 do të kishte qenë në përputhje me nenin 1, Prot. nr.1 të KEDNj-së vetëm nëse gjykatat kombëtare do të kishin vendosur një lidhje ndërmjet veprimtarisë kriminale (ose veprës administrative) nga e cila mund të ishin gjeneruar paratë e përdorura për të blerë pasuritë, nga njëra anë, dhe pasurive si objekt i sekuestrimit, në anën tjetër.

Në çështjen në fjalë, gjykatat bullgare nuk gjetën ekzistencën e një lidhjeje ndërmjet veprave (penale ose administrative) dhe pasurive në fjalë. Për rrjedhojë, standardet e kërkuara të mbrojtjes nuk ishin përmbushur dhe ndërhyrja në të drejtat e kërkuesve ishte joproporcionale.

Nisur nga sa u shpalos më sipër, GjEDNj konstaton se Bullgaria ka shkelur nenin 1, Prot. nr.1 të KEDNj-së, sepse gjykatat e brendshme nuk arritën të vendosnin një lidhje ndërmjet veprave (administrative ose penale) dhe pasurive, që janë objekt i sekuestrimit, duke kufizuar kështu në mënyrë disproporcionale të drejtën e pronës.



Ky vendim konfirmon se masat për sekuestrimin e pasurive duhet të respektojnë standardet e proporcionalitetit dhe të drejtës për një proces të rregullt. Rasti tregon se shtetet nuk mund të konfiskojnë pasuri thjesht mbi bazën e mungesës së provave për origjinën e ligjshme të tyre, pa vendosur një lidhje të qartë me një vepër të paligjshme. Për më tepër, zbatimi prapaveprues i ligjeve dhe përmbysja e barrës së provës cenojnë sigurinë juridike dhe parimin e shtetit të së drejtës.

12. Rasti Osmani kundër Shqipërisë (nr. 8706/18)



Vendimi gjyqësor i datës 5 dhjetor 2023 [komiteti]

Në rastin e shpronësimit, autoritetet kombëtare duhet të japin arsye për shumën e kompensimit dhe të japin dëmshpërblimin e duhur monetar. Mosveprimi në këtë mënyrë përbën shkelje të nenit 6, par. 1²⁶ (E drejta për proces të rregullt – E drejta për vendim të arsyetuar) dhe nenit 1 Prot. nr. 1 (Mbrojtja e pronës) të KEDNJ-së.

Në çështjen Osmani kundër Shqipërisë²⁷ GjEDNJ shqyrtoi një rast që lidhej me shpronësimin dhe kompensimin e pronës. Në vitin 2010, autoritetet kombëtare i kërkuan kërkuesit (shtetas shqiptar) të lironte pronën e tij për qëllim të ndërtimit të një rruge të re. Gjatë këtij viti, disa nga ndërtimet e tij u prishën, megjithëse procedura zyrtare e shpronësimit nuk përfundoi deri në vitin 2015.

Kërkuesi paraqiti padi në gjykatat vendase, duke kërkuar kompensim për dëmin e pësuar dhe për shpronësimin de facto të një pjese të truallit të tij. Autoriteti kombëtar i përfshirë në ndërtimin e rrugës deklaroi se shuma e kompensimit ishte 20 euro për m². Një ekspert i caktuar nga gjykata konstatoj se çmimi i tregut për metër katror të tokës së kërkuesit ishte 160 euro.

Më vonë, eksperti e plotësoi vlerësimin duke i'u referuar një pjese të legjislacionit kombëtar, i cili fiksonte çmim-

in e referencës së truallit për metër katror në kuadër të procedurave të kompensimit për tokat e shpronësuar gjatë regjimit komunist. Sipas këtij legjislacioni, trualli i kërkuesit vlerësohej me 86 euro/m². Kërkuesi e kundërshtoi këtë vlerësim dhe kërkoi kompensim prej 200 euro/m².

Gjykata e Rrethit Tiranë vendosi në vitin 2012 që trualli ishte shpronësuar siç duhej dhe caktoi një kompensim prej rreth 20 euro/m², vendim që kërkuesi e kundërshtoi, duke argumentuar se nuk ishin dhënë arsye të mjaftueshme për shumën e kompensimit.

Rrjedhimisht, kërkuesi u ankua në GjEDNJ me pretendimet se mungesa e arsytimit të vendimeve të gjykatave shqiptare kishte të bënte me shkelje të të drejtave të tij të garantuara nga KEDNJ. Pas shqyrtimit të çështjes, GjEDNJ konstatoi se autoritetet shqiptare kishin marrë pronën e kërkuesit përmes një shpronësimi de facto pa dhënë një konsideratë të qartë mbi "interesin publik" dhe pa siguruar një kompensim të drejtë. Prandaj, nuk ishte e paarsyeshme që kërkuesi të priste kompensim të plotë për dëmin e shkaktuar.

Sipas vlerësimit të GjEDNJ-së, gjykatat kombëtare nuk dhanë asnjë arsye mbi elementet që i çuan ato në mbajtjen e atij qëndrimi dhe në rrëzimin e parashtrimeve të tjera, veçanërisht propozimet e ekspertit. Prandaj, gjykatat kombëtare nuk arritën të angazhoheshin siç duhej ose të jepnin një përgjigje specifike dhe të qartë ndaj pretendimit kryesor të kërkuesit.

26 Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t'i ndalojë shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohet nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtojte interesat e drejtësisë.

27 Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Rasti Osmani kundër Shqipërisë, kërkesa nr. 8706/18 Vendimi gjyqësor i datës 5 dhjetor 2023.

Gjykatat kombëtare kanë detyrimin të shqyrtojnë me rigorozitet dhe kujdes të veçantë pretendimet në lidhje me ndonjë shkelje të mundshme të të drejtave të KEDNj-së. Në çështjen në fjalë, gjykatat më të larta shqiptare rrëzuan pretendimet e kërkuarit pa adresuar pretendimin e tij për shkeljen e mundshme të të drejtave të tij në KEDNj për shkak të mungesës së arsyeve për llogaritjen e shumës së kompensimit. Si përfundim, gjykatat kombëtare nuk dhanë arsye në lidhje me shumën e kompensimit dhe ato nuk dhanë kompensimin e duhur për pronën që autoritetet vendore i kishin shpronësuar kërkuarit.

Nisur nga sa u shpalos më sipër, GjEDNj konstatoj se Shqipëria ka shkelur nenin 6, par. 1, si dhe nenin 1, Prot. nr. 1 të KEDNj-së për shkak se gjykatat kombëtare nuk kishin dhënë një vendim të arsyetuar për shumën e kompensimit dhe nuk siguruan dëmshpërblimin e duhur për pronën e shpronësuar.



Ky rast vë në dukje rëndësinë thelbësore të respektimit të të drejtave themelore të njeriut në procedurat e shpronësimit, veçanërisht të drejtës për një proces të rregullt dhe mbrojtjes së pronës.

13. Rasti Altius Insurance LTD kundër Qipros

(nr. 41151/20)



Vendimi gjyqësor i datës 24 tetor 2023

Gjykatat kombëtare kanë detyrimin të shqyrtojnë çështje relativisht të lehta brenda një afati të arsyeshëm, në përputhje me standardet e KEDNj-së. Mosveprimi në këtë mënyrë përbën shkelje të nenit 6 par.1 të KEDNj-së (E drejta për proces gjyqësor brenda një afati të arsyeshëm).

Në lidhje me të drejtën për proces gjyqësor brenda një afati të arsyeshëm, mjete juridik kombëtar për kompensimin që detyron kërkuesin të ndajë kërkesat e tij për kompensim sipas shkallëve të gjyqësorit (i) pengon vlerësimin e kohëzgjatjes së përgjithshme të proceseve gjyqësore dhe (ii) mund të ndikojë në masën e kompensimit të dhënë. Kjo përbën shkelje të nenit 1328 (E drejta për zgjidhje efektive) në lidhje me nenin 6 të KEDNj-së.

Në çështjen Altius Insurance Ltd kundër Qipros²⁹ GjEDNJ shqyrtoi një rast që lidhej me zgjatjen e procedurave civile dhe efektivitetin e mjeteve juridike në dispozicion për të adresuar këto vonesa.

Kërkuesi është një shoqëri tregtare e themeluar sipas ligjit qipriot, e cila ka vepruar si e paditur në proceset civile për shkelje të një kontrate. Rrjedhimisht, në vitin

2004, kundër Altius Insurance Ltd u ngrit një padi civile për shkelje të kontratës. Gjykata e shkallës së parë e hodhi poshtë padinë në vitin 2010, pas disa shtyrjeve të seancave dhe hapave procedural të ndërmarra nga të dyja palët. Pas apelimit, në vitin 2017, Gjykata e Lartë përmbysi vendimin dhe urdhëroi shoqërinë kërkuese të paguante pothuajse 2 milionë euro dëmshpërblim, plus kostot dhe shpenzimet ligjore.

Në vitin 2018, kërkuesi ngriti padi civile për t'u ankuar për kohëzgjatjen e përgjithshme të proceseve të brendshme gjyqësore. Padia u ngrit bazuar në një ligj kombëtar të vitit 2010 që parashikonte mjete juridike efektive për tejkalimin e afatit të arsyeshëm. Me një vendim të vitit 2020, Gjykata e Lartë rrëzoi pretendimin e kërkuesit në lidhje me kohëzgjatjen e proceseve në shkallë të parë për shkak se ankimi ishte paraqitur jashtë afatit (një vit nga marrja e vendimit të gjykatës së shkallës së parë).

Për sa i përket pretendimit të shoqërisë kërkuese në lidhje me kohëzgjatjen e proceseve gjyqësore në apel, Gjykata e Lartë vuri në dukje se proceset e përgjithshme zgjatën pothuajse 7 vjet, duke tejkaluar kështu kërkesën për afat të arsyeshëm; rrjedhimisht, kërkuesit i'u dha dëmshpërblim 5.000 euro.

Gjykata solli në vëmendje praktikën e saj gjyqësore të mirë konsoliduar mbi të drejtën për një proces gjyqësor brenda një afati të arsyeshëm. Në çështjen në shqyrtim,

28 Çdokush, të cilit i janë shkelur të drejtat dhe liritë e përcaktuara në këtë Konventë, ka të drejtën e një zgjidhjeje efektive para një organi kombëtar, pavarësisht se shkelja është kryer nga persona që veprojnë në përmbushje të funksioneve të tyre zyrtare.

29 Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Altius Insurance Ltd kundër Qipros, kërkesa nr. 41151/20, 24 tetor 2023.

proceset para gjykatave kombëtare zgjatën mbi 13 vjet (2004-2017). Çështja në lidhje me shkeljen e kontratës nuk ngriti pyetje jashtëzakonisht komplekse të ligjit. Vonesat e pakta që i atribuohen shoqërisë kërkuese për shkak të kërkesave për shtyrjen e proceseve gjyqësore të shkallës së parë nuk mund të konsiderohen si faktor i rëndësishëm që justifikon kohëzgjatjen e tyre. Për më tepër, nuk kishte rrethana të jashtëzakonshme që të justifikonin kohëzgjatjen e tyre të përgjithshme.

GjEDNJ konstatoi se zgjatja e procedurave civile prej më shumë se 13 vjetësh përbënte shkelje të nenit 6, par. 1 të KEDNJ-së, i cili garanton të drejtën për një gjykim brenda një afati të arsyeshëm. Gjithashtu, GjEDNJ vuri në dukje se mjetet juridike të disponueshme në sistemin gjyqësor qipriot nuk ishin efektive për të adresuar këto vonesa, duke shkelur kështu nenin 13 të KEDNJ-së, që garanton të drejtën për një mjet efektiv juridik.

Sa i përket nenit 13 të KEDNJ-së, Gjykata theksoi se një mjet kombëtar për t'u ankuar për kohëzgjatjen e proceseve është "efektiv" sipas kuptimit të kësaj dispozite nëse individët mund ta përdorin atë për të përshpejtuar proceset përpara gjykatave kombëtare ose për të marrë kompensimin e duhur për vonesat që kanë ndodhur tashmë. Nëse një sistem ligjor i brendshëm ka parashikuar ngritjen e padisë kundër shtetit, ky veprim duhet të mbetet një mjet juridik efektiv, i mjaftueshëm dhe i qasshëm në lidhje me kohëzgjatjen e tepruar të proceseve gjyqësore. Vonesat e tepërta dhe masa e kompensimit janë elemente që duhen marrë parasysh kur vlerësohet nëse mjeti juridik është i mjaftueshëm në këtë drejtim.³⁰

Në çështjen në fjalë, mjeti sipas ligjit të vitit 2010 nuk ofronte një mjet efektiv për të përshpejtuar proceset ose për të shmangur zgjatjen e tyre të tepërt, sepse nuk kishte asnjë provë që metodat e përcaktuara sipas

atij ligji do të jepnin rezultat de facto. Gjithashtu, ndarja e kërkesave për kompensim sipas shkallëve të gjyqësorit (shkallës së parë dhe të dytë) ishte në kundërshtim me qasjen e gjykatës për shqyrtimin e kohëzgjatjes së përgjithshme të proceseve.

Një mjet juridik i brendshëm për kohëzgjatjen e tepërt të proceseve është "efektiv" sipas kuptimit të nenit 13 KEDNJ-së dhe nenit 35, par.1 të KEDNJ-së³¹ vetëm nëse është në gjendje të mbulojë të gjitha fazat e proceseve për të cilat është bërë ankimi dhe kështu të marrë parasysh kohëzgjatjen e tyre të përgjithshme.

Nisur nga sa u shpalos më sipër, GjEDNJ konstatoj se Qipro ka shkelur nenin 13 në lidhje me nenin 6, par. 1 të KEDNJ-së, për shkak të mos ofrimit të mjeteve juridike të brendshme efektive për të dhënë dëmshpërblim në rast të kohëzgjatjes së tepërt të proceseve gjyqësore.



Ky rast tregon qartë rëndësinë e garantimit të së drejtës për një proces gjyqësor brenda një afati të arsyeshëm, si dhe nevojën për mjete juridike efektive për të adresuar zgjatjen e pajustificuar të procedurave gjyqësore.

³⁰ Shihni *Bara dhe Kola kundër Shqipërisë*, Kërkesat nr. 43391/18 dhe 17766/19, 12 tetor 2021.

³¹ Gjykata mund të trajtojë çështjen vetëm pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet e brendshme ligjore sipas rregullave përgjithësisht të pranuar të të drejtës ndërkombëtare dhe brenda një periudhe prej katër muajsh nga data në të cilën është marrë vendimi i formës së prerë.

14. Rasti Ben Amamou kundër Italisë

(Nr. 49058/20)



Vendimi gjyqësor i datës 29 qershor 2023

Në një proces gjyqësor, kur një gjykatë vendos të mbështetet në një argument ligjor të ri, të cilin e ngrit ex officio (me iniciativën e saj) dhe mbi të cilin bazohet refuzimi i një ankese, ajo ka detyrimin të informojë palën e prekur. Kjo i jep personit të interesuar mundësinë për të paraqitur argumentet e tij dhe për të kundërshtuar këtë arsyetim, në përputhje me parimin e kontradiktoritetit dhe barazinë e armëve. Mosveprimi në këtë mënyrë përbën shkelje të nenit 6, par.1 të KEDNJ -së (E drejta për një proces të rregullt).

Në çështjen Ben Amamou kundër Italisë³² GjEDNJ shqyrtoi ankesën e një shtetasi tunizian, z. Ben Amamou, i cili pretendonte se refuzimi i autoriteteve italiane për t'i ofruar një proces të drejtë gjyqësor në lidhje me kërkesën e tij për kompensim pas një aksidenti rrugor përbënte shkelje të të drejtave të tij, të parapara në KEDNJ.

Kërkuesi është një shtetas tunizian që jetonte në Itali. Në vitin 2010, drejtuesi i një mjeti ku ndodhej kërkuesi manovroi papritur për të shmangur përplasjen me një automjet që nuk u identifikua. Si rezultat, kërkuesi pësoi lëndime trupore që u vlerësuan të rënda në masën 85% dhe paaftësi të përhershme për punë.

Kërkuesi filloi proces gjyqësor për kompensim kundër siguruesit të automjetit me të cilin ai kishte udhëtuar. Ai kërkoi kompensim si “pasagjer i thjeshtë”. Në prill 2015, gjykata e shkallës së parë hodhi poshtë kërkesën e tij, duke argumentuar se një nga dy kushtet e përcaktuara në ligjin vendas për sigurimin nuk ishte përmbushur, pasi aksidenti ishte shkaktuar nga një automjet i paidentifikuar.

Kërkuesi paraqiti ankesë në Gjykatën e Kasacionit duke kërkuar interpretimin dhe zbatimin e rregullave për kompensimin në raste të aksidenteve me automjete të paidentifikuara ose të pasiguruara. Në vitin 2019, Gjykata e Kasacionit rrëzoi ankesën e kërkuesit duke u shprehur se, në raste të tilla si të kërkuesit, i dëmtuari duhet të kontaktojë ekskluzivisht shoqërinë e caktuar nga Fondi i Garancisë për viktimat e aksidenteve rrugore. Gjithash-tu, Gjykata e Kasacionit vërejti se “pasagjeri i thjeshtë” mund të vepronte drejtpërdrejt kundër siguruesit të transportuesit të tij vetëm nëse është e mundur të përcaktohet (ose të supozohet) përgjegjësia e përbashkët e drejtuesit të mjetit në të cilin “pasagjeri i thjeshtë” ishte duke udhëtuar, kusht që nuk plotësohej në rastin në fjalë.

Pra, vendimi i gjykatës u mbështet në një interpretim të ri të rregullave mbi përgjegjësinë në aksidentet rrugore, duke argumentuar se kërkuesi nuk kishte të drejtë të kërkonte kompensim nga siguruesi i automjetit për sa kohë që nuk ishte konstatuar përgjegjësi e përbashkët nga drejtuesi i tij. Ky interpretim i ri ndryshoi të kuptuarit e mëparshëm të ligjit, i cili e kishte njohur më parë të drejtën e pasagjerëve të kërkonin kompensim nga siguruesi i automjetit me të cilin udhëtonin, pavarësisht nëse shoferi i tyre mbante përgjegjësi të drejtpërdrejtë për aksidentin.

32 Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, *Ben Amamou kundër Italisë* (kërkesa nr. 49058/20), 29 qershor 2023.

Rrjedhimisht, kërkuesi paraqiti ankesë pranë GjEDNJ-së, duke pretenduar se refuzimi i autoriteteve italiane për të shqyrtuar si duhet çështjen e tij dhe mungesa e mundësisë për t'iu kundërvënë shkaqeve vendimtare ligjore të sjella ex officio nga gjykata përbënin shkelje të nenit 6(1) të KEDNJ-së.

Pas shqyrtimit të çështjes, GJEDNJ konstatoi se Gjykata e Kasacionit kishte për detyrë të informonte palët për interpretimin e ri të ligjit të brendshëm, duke qenë se ai kishte ndryshuar gjatë procesit dhe, prandaj, kërkuesi nuk supozohej të kishte dijeni për këtë interpretim të ri. Gjykata vlerësoi se arsyeja e ngritur ex officio nga Gjykata e Kasacionit ishte e re dhe e diskutueshme, pasi ajo ishte ende objekt i mendimit të ndryshëm doktrinor dhe konflikt jurisprudence, i cili vazhdonte ende pas vendimit të Gjykatës së Kasacionit për çështjen e kërkuesit.

Gjithashtu, mungesa e përgjegjësisë së përbashkët përcaktoi rezultatin e çështjes dhe ishte vendimtare për refuzimin e ankimit të kërkuesit. Për më tepër, çështjet në fjalë nuk ishin të papërfillshme, sepse kërkuesi nuk ishte kompensuar pavarësisht dëmit të rëndë të pësuar prej tij dhe pasojave të tij. Në këtë drejtim, pas vendimit të Gjykatës së Kasacionit, kërkuesi nuk mund të mbështetej më në fondin e garancisë për viktimat e aksidenteve rru-gore, sepse padia përkatëse ishte parashkruar.

Nisur nga sa më sipër, informuar kërkuesin (dhe palët e tjera) mbi zëvendësimin ex officio të shkaqeve, duke konsideruar se kërkuesi ishte "kapur në befasi" dhe nuk kishte mundësi të paraqiste argumentet e tij mbi një pyetje e cila ishte vendimtare për rezultatin e procesit. Kështu, ai përfitoi nga e drejta për një proces gjyqësor të drejtë për shkak të shkeljes së parimit të kontradiktoritetit.



Ky vendim riafirmon rëndësinë e parimit të kontradiktoritetit dhe barazisë së armëve në proceset gjyqësore, duke i detyruar gjykatat kombëtare të informojnë palët për çdo ndryshim të rëndësishëm në arsyetimin ligjor, në mënyrë që t'u jepet mundësia të mbrojnë interesat e tyre në mënyrë efektive.

15. Rasti Plechlo kundër Sllovakisë

(Nr. 18593/19)



Vendimi gjyqësor i datës 26 tetor 2023

Shtetet anëtare kanë detyrim të sigurojnë një kuadër ligjor të qartë dhe efektiv, i cili garanton mbrojtje kundër keqpërdorimit të përgjimeve të thirrjeve telefonike gjatë hetimeve penale. Kjo mbrojtje është veçanërisht e rëndësishme kur përgjimi përfshin persona të tretë, të cilët nuk janë objekt i drejtpërdrejtë i hetimit apo i urdhrave për përgjim. Mungesa e garancive të përshtatshme dhe mekanizmave efektivë për të mbrojtur të drejtat e këtyre individëve përbën një shkelje të nenit 8 KEDNj-së, i cili mbron të drejtën për respektimin e jetës private dhe familjare.

Në çështjen Plechlo kundër Sllovakisë³³ GjEDNj shqyrtoi një rast që lidhej me përgjimin dhe regjistrimin e bisedave telefonike të kërkuesit. Në vitin 2006, gjykatat sllovaqe nxorën një urdhër për përgjimin e thirrjeve telefonike në kuadër të një hetimi (hetimi i vitit 2006) mbi një dyshim për korrupsion brenda Fondit Kombëtar të Pronës (NPF). Në atë kohë, kërkuesi, z. Plechlo, ishte zyrtar i lartë në NPF, por nuk ishte objektivi kryesor i hetimit, por e preku atë vetëm sepse ai ishte në kontakt me personin që ishte objektivi i tij.

Materiali i përgjimit u mbajt nga policia dhe u përfshi në dosjen e një hetimi të veçantë që u hap në vitin 2012, pas regjistrimeve anonime të postuara në internet që pretendonin se e kishin origjinën nga një operacion vëzhgimi i kryer nga shërbimet sekrete sllovaqe në vitet 2005-2006 ("Operacioni Gorilla"). Hetimi i vitit 2012 kishte të bënte me NPF-në, por kërkuesi nuk ishte i përfshirë drejtpërdrejt.

Më vonë, në vitin 2016, në bazë të informacioneve të marra nga "Operacioni Gorilla", u hap një tjetër hetim për keq menaxhimin e pasurive dhe korrupsion të dyshimtë të nivelit të lartë në NPF. Kërkuesi ishte një nga të dyshuarit kryesorë. Disa nga materialet e përgjimit u përfshinë në dosje dhe kërkuesi u akuzua. Kërkuesi vdiq në vitin 2022 dhe në emër të tij vepruan të afërmit e tij.

Me pretendimet se përfshirja e bisedave telefonike të kërkuesit në hetimet e mëvonshme përbënte një ndërhyrje në nenin 8 të KEDNj-së, përkatësisht në të drejtën e tij për respektimin e jetës private dhe të korrespondencë, të afërmit e kërkuesit i u drejtuan GjEDNj-së.

Pas shqyrtimit të çështjes, gjykata rikujtoi se, që një ndërhyrje të jetë në përputhje me nenin 8 të KEDNj-së, ajo duhet të parashikohet me ligj dhe, në kontekstin e vëzhgimit sekret, duhet të shoqërohet me garanci adekuate dhe efektive.³⁴

³³ Plechlo kundër Sllovakisë, Kërkesa nr. 18593/19, 26 tetor 2023.

³⁴ Shih Dragojević kundër Kroacisë, Kërkesa nr. 68955/11, 15 janar 2015.

Fakti që kërkuesi nuk ishte informuar kurrë për ekzistencën e urdhrit të përgjimit, e kishte lënë atë pa asnjë mundësi për të kundërshtuar këtë masë në gjykatë. Gjithashtu, Gjykata vërejti se materialet e përgjimit të vitit 2006 u përdorën 10 vjet më vonë, në një kontekst krejtësisht të ndryshëm, pa u verifikuar nëse përdorimi i tyre ishte i ligjshëm dhe i justifikuar. Sipas GjEDNj, në një sistem të mbrojtjes së duhur të të drejtave të njeriut, nuk duhet të jetë e mundur që materialet e përgjimit të përdoren për një periudhë të pacaktuar pa kontroll dhe pa garanci adekuate.

Për më tepër, nuk ka asnjë mekanizëm për të mbrojtur të drejtat e personave të prekur rastësisht nga urdhër-përgjimet telefonike. Në fakt, legjislacioni kombëtar për urdhrat e përgjimit të telefonit siguron vetëm mbrojtje për të drejtat e njerëzve të prekur drejtpërdrejt nga urdhra të ngjashme.

Nisur nga sa më sipër, Gjykata konstatoj se Sllovakia ka shkelur nenin 8 të KEDNj-së, sepse ndërhyrja në të drejtën e kërkuesit për respektimin e jetës së tij private dhe korrespondencës nuk ishte në përputhje me ligjin për qëllimin e nenit 8, paragrafit 2 të KEDNj-së, sepse nuk shoqërohej me garanci adekuate dhe efektive kundër abuzimit.



Ky vendim ka implikime të rëndësishme për rregullimin e përgjimeve telefonike në shtetet anëtare të GjEDNj-së, duke riafirmuar se autoritetet shtetërore duhet të garantojnë mbrojtje të përshtatshme për personat që preken aksidentalisht nga përgjimi dhe të sigurojnë mekanizma efektivë për t'u ankuar.

16. Rasti X kundër Greqisë

(nr. 38588/21)



Vendimi gjyqësor i datës 13 shkurt 2024

Në rastet e pretenduara të përdhunimeve, autoritetet kombëtare kanë detyrimin të kryejnë hetime efektive, të informojnë viktimat për të drejtat e tyre dhe të marrin masa për të shmangur traumatizmin e mëtejshëm, duke përfshirë shmangien e kontakteve midis viktimës dhe të dyshuarit. Gjithashtu, shtetet duhet të marrin parasysh rrethanat specifike të çështjes, si mosha e viktimës, dhe të kryejnë një vlerësim të ndjeshëm ndaj kontekstit për besueshmërinë e versioneve të ndryshme të ngjarjes, duke marrë parasysh rezultatet e ekzaminimeve mjekësore. Në të kundërtën, mosveprimi në këtë mënyrë paraqet shkelje të nenit 3 (Ndalimi i torturës)³⁵ dhe të nenit 8 të KEDNJ-së (E drejta për respektimin e jetës private).

Në çështjen X kundër Greqisë³⁶, me vendim të datës 13 shkurt 2024, GjEDNJ shqyrtoi ankesën e znj. X, një shtetase britanike e lindur në vitin 2000, e cila pretendonte se ishte viktimë e përdhunimit nga një banakier hoteli gjatë pushimeve në Greqi në shtator 2019.

Kërkuesja, znj. X, është një shtetase britanike e lindur në vitin 2000, e cila pretendon se ka qenë viktimë e përdhunimit nga një banakier hoteli në Greqi në shtator 2019, ku shkoi për pushime me mamanë e saj. Ajo bëri një kallëzim penal gjatë natës dhe pretendimi i saj u trajtue nga disa policë meshkuj. Më pas, ajo u dërgua në

komisariat ku ndodhej edhe autori, ku e identifikoi atë, pa u ndjekur asnjë procedurë zyrtare. Pas kërkesës së saj për një përkthyes zyrtar që të jepte deklarinimin e saj, oficeri i policisë e informoi se nuk ishte në dispozicion asnjë përkthyes dhe e ndihmoi një përkthyes jozyrtar.

Znj. X dhe nëna e saj u dërguan në spital, ku ajo i'u nënshtrua një ekzaminimi fizik nga një mjek mashkull, i cili konstatoi mavijosje dhe lëndime të freskëta. Gjatë dhe pas ekzaminimit, asaj nuk i'u dha asnjë shpjegim apo dokumentacion mbi procedurat e kryera. Për më tepër, nuk u morën masa për të shmangur kontaktin e saj me të dyshuarin.

I akuzuari akuzohej për veprën penale të përdhunimit. Pasi dha deklarinimin e tij mbrojtës, ai u la i lirë në pritje të gjykimit. Në përputhje me konkluzionin e prokurorit, në vitin 2021 gjykata penale e shpalli të pafajshëm të akuzuarin me arsyetimin se provat e mbledhura gjatë hetimit (deklarimet e dëshmitarëve, raporti mjeko-ligjor, dokumentet dhe deklarimi i të akuzuarit) nuk përbënin indicie të mjaftueshme për të ngritur akuzë penale. Në të njëjtën kohë, vendimi nuk ngarkonte shpenzime ndaj znj. X, sepse nuk ishte provuar që ankesa e saj ishte tërësisht e rreme, tepër e pakujdesshme ose e shtrembëruar.

Megjithatë, në lidhje me procesin e zhvilluar, kërkuesja nuk mori asnjë informacion gjatë gjithë kohës. Pas një përpjekjeje të pasuksesshme për të marrë informacione mbi çështjen përmes Ambasadës Britanike në Athinë, në janar 2021 konsulli më në fund informoi përfaqësuesin e kërkueses se i akuzuari ishte shpallur i pafajshëm. Konsulli i sugjeroi gjithashtu familjes së

³⁵ Askush nuk mund t'i nënshtrohet torturës ose dënimeve ose trajtimeve çnjerëzore ose poshtëruese.

³⁶ Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, X kundër Greqisë (kërkesa nr. 38588/21), Vendimi gjyqësor i datës 13 shkurt 2024

kërkueses të caktonte një avokat vendas. Kërkuesja dhe përfaqësuesi i saj i dërguan një email gjykatës dhe prokurorisë, ku i kërkuan informacion mbi çështjen, si dhe qasje në të gjitha dosjet policore dhe spitalore, si dhe informacione mbi procedurën.

Prokuroria refuzoi kërkesën e tyre për arsye se kërkuesja nuk ishte palë civile në çështje (ajo nuk e kishte deklaruar këtë në deklarinimin e saj dhe kishte paguar tarifën përkatëse) dhe se afati përkatës kishte mbaruar. Megjithatë, prokuroria e njoftoi atë për vendimin për lirim e të akuzuarit. Prokuroria përsëriti deklaratën e saj drejtuar Ambasadës Britanike në Athinë dhe shtoi se kërkuesja nuk ishte paraqitur për të dëshmuar para gjyqarit hetues një ditë pas incidentit dhe nuk kishte caktuar një avokat për ta përfaqësuar atë.

Pas shqyrtimit të kësaj çështjeje, GjEDNJ konstatoj se përdhunimi dhe dhuna e rëndë seksuale përfshihen në objektin e nenit 3³⁷ dhe të nenit 8³⁸ të KEDNJ-së.

Detyrimet pozitive sipas nenit 3 dhe 8 të KEDNJ-së kërkojnë që shtetet të marrin masa për të shmangur viktimizimin dytësor në proceset penale, si dhe për të vazhduar penalizimin dhe ndjekjen penale efektive të çdo akti seksual pa pëlqim, sidomos në mungesë të kundërshtimit fizik nga viktimat. Për të qenë efektive, hetimi duhet të jetë mjaftueshëm i plotë dhe objektiv. Autoritetet duhet të marrin masat e arsyeshme në dispozicion të tyre për të marrë prova në lidhje me veprën në fjalë.

Sipas GjEDNJ-së, edhe pse Greqia kishte një kuadër ligjor dhe rregullator të përshtatshëm për t'u marrë me rastet e përdhunimeve, autoritetet kombëtare nuk e zbatuan atë në praktikë. Autoritetet nuk adoptuan një qasje të ndjeshme, e cila kërkohej për shkak të natyrës intime të çështjes, moshës së re të kërkueses si dhe faktit që ajo pretendonte se ishte përdhunuar gjatë pushimeve në një vend të huaj. Autoritetet e brendshme nuk kryen një hetim efektiv, ato shpërfillën të drejtat dhe nevojat e viktimës, krahas rrezikut të viktimizimit dytësor dhe traumatizimit të mëtejshëm.

Nisur nga sa më sipër, GjEDNJ konstatoj se Greqia ka shkelur nenet 3 dhe 8 të KEDNJ-së për shkak të mungesës së përgjigjes adekuate nga autoritetet hetimore dhe gjyqësore ndaj pretendimeve të kërkueses për përdhunim.

GjEDNJ theksoi se, në rastet e pretenduara të përdhunimit, autoritetet kombëtare kanë detyrimin të kryejnë hetime efektive, të informojnë viktimat për të drejtat e tyre dhe të marrin masa për të shmangur traumatizimin e mëtejshëm, duke përfshirë shmangien e kontakteve midis viktimës dhe të dyshuarit. Gjithashtu, gjykatat duhet të marrin parasysh rrethanat specifike të çështjes, si moshë e viktimës, dhe të kryejnë një vlerësim të ndjeshëm ndaj kontekstit për besueshmërinë e versioneve të ndryshme të ngjarjes, duke marrë parasysh rezultatet e ekzaminimeve mjekësore. Autoritetet hetimore dhe gjyqësore duhet të ndjekin një qasje të bazuar në perspektivën gjinore.



Ky vendim i GjEDNJ-së thekson përgjegjësinë e shteteve anëtare për të siguruar një përgjigje efektive dhe të ndjeshme në rastet e përdhunimeve dhe dhunës seksuale.

37 Askush nuk mund t'i nënshtrohet torturës ose dënimeve ose trajtimeve çnjerëzore ose poshtëruese.

38 Çdokush ka të drejtën e respektimit të jetës së tij private dhe familjare, banesës dhe korrespondencës së tij. Autoriteti publik nuk mund të ndërhyjë në ushtrimin e kësaj të drejte, përveçse në shkallën e parashikuar nga ligji dhe kur është e nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit publik, shëndetit ose moralit ose për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të tjerëve

17. Rasti Matyushonok kundër Ukrainës

(Nr.34590/06)



Vendimi gjyqësor i datës 11 korrik 2024 [Komiteti]

Autoritetet kombëtare kanë detyrimin të mos i nënshtrojnë të burgosurit ndaj keqtrajtimit në burg dhe të hetojnë akuzat në këtë drejtim. Mosveprimi në këtë mënyrë mund të përbëjë shkelje të nenit 3 KEDNj-së (Ndalimi i torturës).

Në çështjen Matyushonok kundër Ukrainës³⁹ me vendim të datës 11 korrik 2024, GjEDNj shqyrtoi ankesën e një shtetasi ukrainas, i cili aktualisht vuan dënimin me burgim të përjetshëm për vrasje me paramendim të kryer si pjesë e një grupi.

Kërkuesi, së bashku me të pandehur të tjerë, në vitin 2005 u dënua për vrasje me paramendim dhe vepra të tjera penale, duke u dënuar me burgim të përjetshëm dhe konfiskim të pasurisë. Ata paraqitën ankim, duke kërkuar uljen e dënimit dhe marrjen parasysh të rrethanave lehtësuese, si pendimi i sinqertë dhe mosha e kërkuesit. Prokurori gjithashtu rekomandoi uljen e dënimit nga burgim i përjetshëm në burgim me afat të caktuar.

Në shkurt 2006, Gjykata e Lartë shqyrtoi çështjen në mungesë të avokatit të kërkuesit dhe e la në fuqi vendimin e gjykatës më të ulët, duke konfirmuar kështu dënimin e kërkuesit me burgim të përjetshëm.

Që nga tetori 2003, kërkuesi ka qenë subjekt i keqtrajtimit sistematik në burg nga oficerët, sidomos i rrahjes. Ai është ankuar te shefi i ambienteve të burgimit dhe ka kërkuar ndihmë mjekësore, por kërkesat e tij nuk janë marrë parasysh. Për më tepër, kushtet e paraburgimit ishin të papërshtatshme (mungesa e higjienës dhe pastrimit; mungesa e ujit të pijshëm; kequshqyerja) dhe autoritetet nuk i dhanë atij dokumentet që i nevojiteshin për të provuar pretendimin e tij përpara GjEDNj-së.

Rrjedhimisht, kërkuesi përpara GjEDNj-së pretendoi shkelje të nenit 3 të KEDNj-së (ndalimi i torturës dhe trajtimit çnjerëzor ose poshtërues), duke argumentuar se ishte subjekt i keqtrajtimit sistematik në burg dhe se autoritetet nuk kishin kryer një hetim efektiv mbi këto pretendime.

39 Matyushonok kundër Ukrainës, Kërkesa nr. 34590/06, 11 korrik 2024.

Gjykata rikujtoi se, sipas jurisprudencës së saj të konsoliduar, autoritetet kanë detyrimin të mos i nënshtrojnë të burgosurit ndaj keqtrajtimit dhe të hetojnë në mënyrë efektive çdo pretendim në këtë drejtim.

Duke marrë parasysh materialet e paraqitura dhe gjetjet në çështje të ngjashme të mëparshme, Gjykata konstatoi se kishte prova të mjaftueshme për të mbështetur pretendimet e kërkuesit për shkelje të nenit 3 të KEDNj-së.

GjEDNj vendosi se Ukraina kishte shkelur nenin 3 të KEDNj për shkak të keqtrajtimit të kërkuesit në burg dhe mungesës së një hetimi efektiv mbi këto pretendime.

Ky vendim konfirmon standardet e vendosura nga GjEDNj për të drejtat e të burgosurve, duke theksuar se shtetet anëtare janë përgjegjëse për mirëqenien e personave të privuar nga liria, dhe dështimi për të garantuar kushte të pranueshme të burgosjes mund të përbëjë një shkelje të KEDNj-së dhe se të burgosurit duhet të kenë qasje të lirë dhe të pakufizuar në mekanizmat ligjorë për të paraqitur ankesat e tyre, pa asnjë formë presioni apo pengese nga autoritetet.



Ky vendim vendos një precedent të rëndësishëm për mbrojtjen e të drejtave të të burgosurve në të gjithë juridiksionet e KEDNj-së, duke kërkuar përmirësimin e kushteve të burgjeve dhe sigurimin e mekanizmave efektivë për hetimin e keqtrajtimit në institucionet e vuajtjes së dënimit.

18. Rasti Wieder dhe Guarnieri kundër Mbretërisë së Bashkuar (NR. 64371/16 DHE 64407/16)



Vendimi gjyqësor i datës 12 shtator 2023

Nëse përgjimi i komunikimeve të njerëzve që jetojnë jashtë kryhet nga agjencitë kombëtare të inteligjencës që veprojnë brenda territorit të shtetit, atëherë ai shtet po ushtron juridiksionin e tij sipas nenit 1 të KEDNj-së për procesin e përgjimit. Përgjimi i komunikimeve përbën ndërhyrje në të drejtën për jetë private, nëse regjimi i përgjimit në masë ndikohet nga mangësi themelore (p.sh., mungesa e një autorizimi nga një autoritet i pavarur), dhe rrjedhimisht ndërhyrja përbën shkelje të nenit 8 të KEDNj-së (E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare).

Në çështjen Wieder dhe Guarnieri kundër Mbretërisë së Bashkuar⁴⁰, GjEDNj shqyrtoi pretendimet e dy kërkuesve, një shtetas amerikan dhe një italian, të cilët dyshonin se komunikimet e tyre elektronike ishin përgjuar dhe analizuar nga agjencitë e inteligjencës britanike.

Njëri nga kërkuesit ishte profesionist i IT-së, ndërsa kërkuesi tjetër ishte studiues i privatësisë dhe sigurisë, i cili kishte publikuar kërkime mbi mbikëqyrjen dhe privatësinë në media të njohura si Der Spiegel dhe The Intercept. Si rezultat i punës dhe kontratave të tyre, kërkuesit pretendonin se komunikimet e tyre mund të ishin përgjuar, nxjerrë, filtruar, ruajtur, analizuar dhe

shpërndarë nga agjencitë e inteligjencës në Mbretërinë e Bashkuar në përputhje me regjimin kombëtar, ndonëse të dy kërkuesit ndodheshin jashtë territorit britanik.

Kërkuesit fillimisht paraqitën ankesat e tyre pranë Investigatory Powers Tribunal (IPT), që është organi gjyqësor përgjegjës për mbikëqyrjen e veprimtarive të shërbimeve të inteligjencës në Britani. Kjo gjykatë është e vetmja instancë ku individët mund të sfidojnë veprimet e inteligjencës britanike në lidhje me përgjimet dhe mbikëqyrjen.

Në vendimin e saj, IPT e hodhi poshtë ankesën e kërkuesve, duke arsyetuar se kërkuesit nuk mund të provonin se komunikimet e tyre ishin përgjuar konkretisht nga inteligjenca britanike, mekanizmat ekzistues të autorizimit dhe mbikëqyrjes ishin të mjaftueshëm për të mbrojtur të drejtat e individëve sipas ligjeve të Mbretërisë së Bashkuar, dhe se sistemi i përgjimeve ishte në përputhje me nevojat e sigurisë kombëtare dhe nuk kishte dëshmi të përdorimit të tij në mënyrë abuzive ndaj kërkuesve specifik.

Pavarësisht se IPT mbrojti legjitimitetin e sistemit të përgjimit, GjEDNj më parë kishte gjetur shkelje të nenit 8 në një çështje tjetër të rëndësishme – Big Brother Watch dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar (2018 dhe 2021). Në atë rast, GjEDNj kishte konstatuar se regjimi i përgjimeve në Mbretërinë e Bashkuar kishte mangësi themelore dhe për rrjedhojë ishte në shkelje të KEDNj-së.

40 Wieder dhe Guarnieri kundër Mbretërisë së Bashkuar, Kërkesat nr. 64371/16 dhe 64407/16, 12 shtator 2023.

GjEDNJ vlerësoi për herë të parë nëse Mbretëria e Bashkuar kishte juridiksion mbi këtë çështje sipas nenit 1 të KEDNJ-së⁴¹. Gjykata arriti në përfundimin se ndërhyrja kryesore në të drejtat e privatësisë ndodh gjatë përpunimit, ekzaminimit dhe përdorimit të komunikimeve të përgjuara, të cilat janë kryer nga agjencitë e inteligjencës brenda territorit të Mbretërisë së Bashkuar. Për këtë arsye, GjEDNJ konkludoi se ky shtet kishte ushtruar juridiksion mbi çështjen dhe se ankesa ishte e pranueshme.

Nisur nga sa më sipër, Gjykata vlerësoi se ndërhyrja në të drejtat e kërkuesve sipas nenit 8 të Konventës ndodhi brenda Mbretërisë së Bashkuar dhe për këtë arsye përfshihej në juridiksionin e saj tokësor, për qëllimin e nenit 1 të Konventës⁴².

Në rastin konkret, GjEDNJ konstatoi se regjimi i përgjimit në Mbretërinë e Bashkuar përcjellej me mangësi themelore. Rrjedhimisht, Gjykata konstatoj se Mbretëria e Bashkuar ka shkelur nenin 8 të Konventës, përkatësisht për shkak të: i) mungesës së autorizimit të pavarur, përkatësisht se autoritetet e inteligjencës kishin kompetenca të gjera për të vendosur për përgjimet, pa pasur nevojë për një mbikëqyrje të jashtme dhe të pavarur.; ii) mos përfshirjes së kategorive të përzgjedhësve në kërkesën për autorizim; iii) dhe faktit që përzgjedhësit e lidhur me një individ nuk i nënshtrohen autorizimit të brendshëm paraprak.



Ky vendim ka implikime të rëndësishme për regjimin e përgjimeve në shtetet anëtare të GjEDNJ-së, duke riafirmuar se shtetet kanë juridiksion mbi çdo përgjim të kryer brenda territorit të tyre, edhe nëse viktimat e mundshme ndodhen jashtë vendit.

41 Palët e Larta Kontraktuese i sigurojnë çdokujt brenda juridiksionit të tyre të drejtat dhe liritë e përcaktuara në Titullin I të kësaj Konvente

42 Palët e Larta Kontraktuese i sigurojnë çdokujt brenda juridiksionit të tyre të drejtat dhe liritë e përcaktuara në Titullin I të kësaj Konvente.

19. Kompania e Transmetimit Radio B92 AD kundër Serbisë

(Nr. 67369/16)



Vendimi gjyqësor i datës 5 shtator 2023

Shtetet kanë detyrimin jo vetëm të mos ndërhyjnë në mënyrë të pajustificuar në të drejtën e mediave për të raportuar mbi çështje me interes publik, por edhe të krijojnë një mjedis ligjor dhe institucional që garanton pluralizmin dhe lirinë e shtypit. Vendosja e dënimeve financiare ose detyrimi për të fshirë artikuj nga mediat duhet të jetë proporcional dhe i justifikuar me një qëllim legjitim, për të shmangur efektin dekurajues (chilling effect) që mund të ndikojë në lirinë e medias.

Në çështjen Kompania e Transmetimit Radio B92 AD kundër Serbisë⁴³, GjEDNJ shqyrtoi një rast që lidhej me lirinë e shprehjes së një kompanie mediatike serbe.

Kërkuesi, Shoqëria e Radio Transmetimit B92 AD, zotëronte një kanal televiziv dhe një portal interneti. Në nëntor 2011, lajmet e mbrëmjes raportuan për një polemikë të vazhdueshme mbi prokurimin e vaksinave të gripit AH1N1 në 2009. Në veçanti, shoqëria raportoi se 12 emra, përfshirë Z.P. (zëvendës-ministre e shëndetësisë në atë kohë), ishin hequr nga lista që kishte policia për të dyshuarit për shpërdorim detyre në lidhje me polemikën, për shkak të presionit politik.

Në ditët në vijim, në portalin e internetit të shoqërisë u transmetuan lajme dhe u publikuan artikuj të ngjashëm. Raportimi u bazua në një shënim të punonjësve të policisë, të cilët i'a dorëzuan atë gazetarëve të shoqërisë. Gjatë raportimit, gazetarët u përpoqën të kontaktojnë persona të interesuar (përfshirë Z.P.).

Pas refuzimit të shoqërisë për të publikuar mohimin, në prill 2012, Z.P. filloi proces civil kundër shoqërisë. Gjykatat e brendshme konstatuan se artikujt online kishin dëmtuar nderin dhe reputacionin e Z.P-së dhe e urdhëruan atë të paguajë dëmin dhe shpenzimet, krahas heqjes së artikullit të kontestuar nga portali i internetit dhe publikimin e vendimit kundër saj. Në vitin 2016, Gjykata Kushtetuese arriti në përfundimin se vendimet në fjalë kishin ndërhyrë në lirinë e shprehjes së shoqërisë, por ndërhyrja kishte qenë e nevojshme për mbrojtjen e të drejtave dhe reputacionit të ankimesit dhe masat korrigjuese ishin proporcionale.

Pas shqyrtimit të çështjes, GjEDNJ konstatoj se vendimi civil i formës së prerë i dhënë kundër shoqërisë kërkuese përbënte "ndërhyrje nga një autoritet publik" në të drejtën e saj për lirinë e shprehjes. Ndërhyrja parashikohej me ligj dhe ndiqte interesin legjitim të mbrojtjes së reputacionit ose të të drejtave të të tjerëve, në përputhje me nenin 10 të KEDNJ-së.

43 Kompania e Transmetimit Radio B92 AD kundër Serbisë, Kërkesa nr. 67369/16, 5 shtator 2023.

Në vlerësimin e proporcionalitetit të kufizimit, GjEDNJ u përqendrua në disa aspekte. Së pari, ajo gjeti se informacioni në fjalë kontribuoi në një debat me interes të përgjithshëm. Së dyti, ajo u shpreh se personi në fjalë ishte një personazh publik dhe, si i tillë, duhej të kishte treguar një shkallë më të madhe tolerance duke pasur parasysh se informacioni lidhej me parregullsi të supozuara në punën e saj dhe jo me jetën e saj private.

Për më tepër, GjEDNJ theksoi se gjykatat e brendshme nuk zbatuan në mënyrën e duhur standardet që ishin në përputhje me parimet e nenit 10 të Konventës, dhe nuk janë bazuar në një vlerësim të pranueshëm të fakteve përkatëse, sepse nuk kishin arritur: i) të shqyrtonin elementet e çështjes që ishin të nevojshme për vlerësimin e pajtueshmërisë së kërkuarit me detyrat dhe përgjegjësitë e tij sipas nenit 10 të KEDNJ-së; ii) të jepnin arsyet përkatëse dhe të mjaftueshme për të justifikuar ndërhyrjen.

Si përfundim, GjEDNJ konstatoi se ndërhyrja në lirinë e shprehjes së kompanisë nuk ishte e nevojshme në një shoqëri demokratike. Ajo vuri në dukje se raportimi i kompanisë bazohej në një dokument zyrtar dhe se çështja e prokurimit të vaksinave ishte me interes të lartë publik. Gjykata theksoi se sanksionet e vendosura mund të kishin një efekt dekurajues në ushtrimin e lirisë së shprehjes nga media. Prandaj, ajo vendosi se kishte pasur shkelje të nenit 10 të KEDNJ-së, i cili garanton lirinë e shprehjes.



Ky vendim riafirmon rëndësinë e mbrojtjes së lirisë së medias dhe vendos standarde të qarta për shtetet anëtare në lidhje me ndërhyrjet ndaj lirisë së shprehjes në çështje me interes publik. Ai forcon detyrimet e shteteve për të garantuar një mjedis ligjor dhe institucional që promovon pluralizmin mediatik dhe parandalon efektin dekurajues ndaj gazetarëve.

20. Vučković kundër Kroacisë (Nr. 15798/20)



Vendimi gjyqësor i datës 12 dhjetor 2023

Në rastet e përdhunimeve dhe dhunës seksuale, gjykatat kombëtare duhet të bëjnë një shqyrtim të kujdesshëm të të gjitha konsideratave përkatëse që lidhen me rastin (duke përfshirë interesat e viktimave dhe pasojat e sulmeve ndaj tyre). Në rast se gjykata e shkallës së dytë zbut dënimin më të rëndë të vendosur nga një gjykatë e shkallës së parë, ajo duhet të japë arsyet e duhura për zbutjen e dënimit.

Dështimi në luftën kundër dhunës ndaj grave në mënyrë efikase mund t'i dekurajojë viktimat nga kallëzimi i krimeve, që përbën shkelje të nenit 3 (Ndalimi i torturës) dhe nenit 8 të KEDNJ -së (E drejta për respektimin e jetës private).

Në çështjen Vučković kundër Kroacisë⁴⁴, GjEDNJ përcaktoj standardet kyçe për mënyrën se si gjykatat kombëtare duhet të trajtojnë rastet e dhunës seksuale dhe përdhunimit.

Kërkuesja është një shtetase kroate që ka punuar si infermiere. Në vitin 2015, ajo bëri një kallëzim penal kundër kolegut të saj (shofer i ambulancës), duke e akuzuar atë për dhunë seksuale (prekje, kapje në pjesë të trupit të saj, përpjekje për të detyruar për të kryer seks oral) gjatë turneve së bashku gjatë periudhës prill - qershor 2015. Veprimet e tij ishin shoqëruar me gjuhë

të papërshtatshme dhe kërcënime se do të pushohej nga puna nëse i tregonte dikujt për atë që kishte ndodhur. Policia ka marrë në pyetje të akuzuarin, i cili në qershor të vitit 2015 u transferua në një pozitë tjetër, për të punuar si shofer ambulance në një qytet tjetër.

Përfundimisht, gjykata e shkallës së parë e shpalli fajtor të akuzuarin për dy akuza për kryerjen e veprimeve të turpshme (çdo veprim me konotacion seksual që nuk arrin në marrëdhënie seksuale pa pëlqim) dhe e dënoi atë me 10 muaj burgim. Gjykata vuri në dukje veçanërisht si faktorë rëndës faktin që veprat seksuale ishin kryer në mënyrë të përsëritur dhe në një interval të shkurtër kohe.

Në vitin 2019, gjykata e shkallës së dytë e konfirmoi dënimin, por zëvendësoi dënimin me burgim me punë në interes të përgjithshëm, e cila u krye në mënyrë të rregullt deri në nëntor 2020. Gjykata e shkallës së dytë konstatoi se puna në interesit publik do ti kishte shërbyer qëllimit të dënimit, duke pasur parasysh se kishin kaluar katër vjet që nga sulmet dhe autori nuk kishte kryer ndonjë krim tjetër. Vendimi ishte i formës së prerë dhe i pandryshueshëm nga rishikimi kushtetues.

Në vitin 2018, kërkuesja paraqiti padi për dëmshpërblim kundër të akuzuarit dhe punëdhënësit të saj, dhe një tjetër padi kundër punëdhënësit të saj për diskriminim. Të dy proceset civile janë ende në pritje në gjykatën e shkallës së parë. Kërkuesja kishte qenë me raport mjekësor për disa periudha si rezultat i dëmtimit në krahun e saj, të shkaktuar nga dhuna e M.P ndaj saj (qershor 2015), ç'rregullim i stresit post-traumatik (korrik - shtator 2015) dhe gjendje akute psikologjike e shkaktuar pas vendimit përfundimtar (tetor 2019 - janar 2020).

44 Vučković kundër Kroacisë, Kërkesa nr. 15798/20, 12 dhjetor 2023.

Pas shqyrtimi të rastit, GjEDNJ konstaton se në rastet e përdhunimit dhe të dhunës seksuale, gjykatat kombëtare duhet të bëjnë një shqyrtim të kujdesshëm të të gjitha konsideratave përkatëse që lidhen me rastin (duke përfshirë interesat e viktimave dhe pasojat e sulmeve ndaj tyre). Në rast se gjykata e shkallës së dytë zbut dënimin më të rëndë të vendosur nga një gjykatë e shkallës së parë, ajo duhet të japë arsyet e duhura për zbutjen e dënit. Dështimi në luftën kundër dhunës ndaj grave në mënyrë efikase mund t'i dekurajojë viktimat nga kallëzimi i krimeve, që nënkupton shkelje të nenin 3 (Ndalimi i torturës) dhe nenit 8 të KEDNJ -së (E drejta për respektimin e jetës private).

Sipas GjEDNJ-së, shtetet kanë detyrimin pozitiv të miratojnë ligje penale që dënojnë në mënyrë efektive përdhunimin dhe t'i zbatojnë ato në praktikë përmes hetimit dhe ndjekjes penale efektive, në mënyrë që të vërtetohet fakti, të identifikohen dhe të ndëshkohen personat përgjegjës. Gjykatat kombëtare penale kanë detyrimin të shqyrtojnë me kujdes të gjitha konsideratat përkatëse në lidhje me çështjen. Masa e dënit duhet të jetë proporcionale me rëndesën e aktit.

Sipas vlerësimit të GjEDNJ-së, gjykatat kombëtare nuk morën kurrë parasysh një sërë faktorësh që ishin të rëndësishëm sipas legjislacionit të brendshëm, të tilla si pasojat për kërkuesen (d.m.th., periudhat e raportit mjekësor), sjelljen e autorit (p.sh., kërcënimet ndaj kërkueses), mungesën e pendimit të tij dhe/ose çdo përpjekje për të kompensuar dëmin e shkaktuar ndaj kërkueses. Duke e ndryshuar dënimin me burg në punë në interes publik, gjykata e shkallës së dytë nuk përmendi faktorët rëndësues të identifikuar nga gjykata e shkallës së parë, si shkalla e lartë e përgjegjësisë penale të autorit apo qëllimi i tij i fortë në kryerjen e veprave seksuale në fjalë. Për më tepër, gjykata e shkallës së dytë nuk shpjegoi pse kalimi i kohës peshoi më shumë se këto rrethana rënduese. Rrjedhimisht, gjykata e shkallës së dytë nuk bëri një shqyrtim të kujdesshëm të të gjitha vlerësimeve përkatëse në lidhje me çështjen.

Nisur nga ajo që u shpalos më sipër, GjEDNJ konstaton se Kroacia ka shkelur nenin 3 dhe nenin 8 të KEDNJ-së për shkak se gjykatat e saj të brendshme nuk i trajtuan siç duhet aktet e përsëritura të dhunës seksuale që kërkuesja kishte pësuar në vendin e saj të punës.



Ky vendim forcon standardet mbi trajtimin e rasteve të dhunës seksuale dhe përdhunimit nga autoritetet gjyqësore në shtetet anëtare të GjEDNJ-së. Ai riafirmon detyrimin e shteteve për të garantuar një sistem ligjor dhe gjyqësor efektiv, që ndëshkon në mënyrë të drejtë dhe proporcionale autorët e dhunës seksuale, duke marrë në konsideratë interesat e viktimave dhe pasojat që sulmet kanë mbi to.

21. Gashi dhe Gina kundër Shqipërisë (Nr.29943/18)



Vendimi gjyqësor i datës 4 prill 2023

Një periudhë e gjatë pezullimi nga detyra mund të ketë ndikim negativ të rëndë në të drejtën e personit për jetë private dhe mund të përbëjë ndërhyrje në këto të drejta. Pezullimi i vazhduar pa bazë ligjore përbën shkelje të nenit 8 të KEDNJ-së (E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare).

Në rastin Gashi dhe Gina kundër Shqipërisë⁴⁵, GjEDNJ shqyrtoi ankesat e dy prokurorëve shqiptarë lidhur me pezullimin e tyre nga detyra pas hetimeve penale mbi deklaratimet e pasurisë së tyre.

Në vitin 2016, Shqipëria filloi një reformë gjithëpërfshirëse të sistemit të drejtësisë, duke përfshirë rivlerësimin e të gjithë prokurorëve në detyrë ("procesit të vettingut"). Në përputhje me Ligjin për Deklarimin e Pasurisë, i cili hyri në fuqi në vitin 2003, kërkuesit paraqitën deklaratimet vjetore të pasurisë pranë Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPI).

Kërkuesja e parë, e cila mbante një post të rëndësishëm si Shefe e Njesisë së Dekriminalizimit, u shkarkua nga detyra në vitin 2018 pas vlerësimit negativ të deklaratës së saj të pasurisë. Në vitin 2018, kërkuesja e parë u pushua nga detyra dhe u pezullua ex lege nga detyrat e saj nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimeve (KPK). Pas ankimit në Kolegjin e Posaçëm të Apelit (KPA), ky i fundit e la në fuqi vendimin e KPK-së.

Kërkuesi i dytë, prokuror në Gjykatën e Rrethit Tiranë, i'u nënshtrua procesit të vettingut në vitin 2020 dhe 2021. Në maj të vitit 2018, i njëjti u pezullua nga detyra për shkak të një hetimi penal ndaj tij dhe bashkëshortes së saj, bazuar në një klasifikim të gabuar të veprës së tij si "krim i rëndë" sipas kuptimit të ligjit kombëtar të vitit 2016. Këto akuza i viheshin mbi barrë për shkak të deklaratimeve të bëra në deklaratimet periodike të pasurisë dhe gjatë procesit të vettingut për sa i përket kërkueses së parë.

Pas ankimit nga kërkuesit kundër urdhrave të pezullimit, KPA i informoi se nuk mund të merrte një vendim në këtë drejtim, sepse një anëtar (I.R.) ishte tërhequr për shkak të konfliktit të interesit dhe, për shkak të mungesës së një rregulloreje specifike në atë kohë, ai nuk mund të zëvendësohej. Në qershor 2018, trupi gjyqësor i KPA-së (përfshirë I.R.) nuk e shqyrtoi ankesën dhe u shpreh se Gjykata Administrative e Apelit ishte organi përgjegjës për shqyrtimin e urdhrave të pezullimit.

Pas ankimit nga kërkuesit, Gjykata Administrative e Apelit rrëzoi kërkesën e kërkuesve për të pezulluar ekzekutimin e këtyre urdhrave me një vendim të ndërmjetëm. Në nëntor 2018, e njëjta gjykatë i shpalli të paligjshëm urdhrat e pezullimit dhe i shfuqizoi ata, për shkak të cilësimit të gabuar të veprave përkatëse si "krime të rënda" sipas legjislacionit të brendshëm të vitit 2016. Ajo gjykoi se vepra për të cilën akuzoheshin kërkuesit – një vepër që dënohej me gjobë ose me burgim deri në tre vjet – ishte në kompetencën e një gjykate rrethi ku mund të gjykohej me një gjyqtar të vetëm, në vend që të gjykohej nga Gjykata për Krime të Rënda. Ky vendim nuk specifikoi nëse bëhej menjëherë i ekzekutueshëm,

dhe, për rrjedhojë, kërkuesit nuk u rikthyen menjëherë në detyrë. Sipas kërkuesve, vendimi ishte menjëherë i ekzekutueshëm, edhe pse ishte i ankimeshëm në Gjykatën e Lartë të Shqipërisë. Prokurori i Përgjithshëm i Përkohshëm kërkoi rishikim për çështjet ligjore në Gjykatën e Lartë.

Në vitin 2019, një zyrë tjetër mori përsipër hetimin penal ndaj kërkuesve dhe kërkoi ndërprerjen e hetimit, i cili u lejua me një vendim gjyqësor të formës së prerë në të njëjtin vit. Vendimi i ndërprerjes u bazua në pamundësinë e përdorimit të vlerësimit të deklaratës për vetting të kërkueses së parë si provë në çdo proces gjyqësor tjetër ndaj saj në pritje të procesit të vettingut.

Kërkuesi i dytë u rikthye në detyrë vetëm në janar 2020, me kërkesë të tij për t'u rikthyer në punë dhe pas disa hapave procedural për t'a ekzekutuar vendimin e Gjykatës Administrative të Apelit. Si kërkuesja e parë ashtu edhe kërkuesi i dyti vazhduan të paguheshin gjatë gjithë periudhës së pezullimit të tyre.

GjEDNJ konstatoi se pezullimi i kërkuesit të dytë për gati dy vite përbënte një ndërhyrje të pajustificuar në të drejtën e tij për jetë private, duke i mohuar mundësinë për të ndjekur karrierën e tij profesionale dhe për të jetuar në një mjedis të qëndrueshëm profesional.

Pezullimi nuk kishte më bazë ligjore pas ndërprerjes së hetimeve në vitin 2019, por ai vazhdoi të mbetej jashtë detyrës, duke krijuar pasiguri të panevojshme. Për këtë arsye, GjEDNJ konstatoi se Shqipëria kishte shkelur nenin 8 të KEDNJ-së për sa i përket kërkuesit të dytë.

Sa i përket kërkueses së parë, ajo u ndalua të ushtonte detyrën e saj si prokurore për dy muaj e gjysmë; ajo vazhdoi të paguhej gjatë kësaj periudhe. Kërkuesja e parë nuk tregoi që pasojat e këtij pezullimi kaq të shkurtër në kohë kishin qenë aq të rënda sa të përfshiheshin në objektin e nenit 8 të KEDNJ-së. Nisur nga sa më sipër, ankesa e kërkueses së parë është e pajtueshme *ratione materiae* me nenin 8 të KEDNJ-së dhe duhet të refuzohet në përputhje me nenin 35, par. 4 të KEDNJ-së.

Nisur nga sa u shpalos më sipër, GjEDNJ konstatoj se Shqipëria ka shkelur nenin 8 të KEDNJ-së për shkak të pezullimit të vazhdueshëm të kërkuesit të dytë pa bazë ligjore.



Ky vendim detyron shtetet anëtare të KEDNJ-së të marrin masa për të mbrojtur individët nga pezullimet e pajustificuara dhe të sigurojnë që çdo ndërhyrje në të drejtat e tyre të jetë në përputhje me parimin e ligjshmërisë dhe proporcionalitetit.

Lista e rasteve

Neni 2	→ Tërshana kundër Shqipërisë, Nr. 48756/14, 4 nëntor 2020;
Neni 3	→ X kundër Greqisë, Nr. 38588/21, 13 shkurt 2024; → Matyoshonok kundër Ukrainës, Nr. 34590/06, 11 korrik 2024; → Vučković kundër Kroacisë, Nr. 15798/20, 12 dhjetor 2023;
Neni 5	→ M.B kundër Holandës, Nr.71008/16, 23 prill 2024;
Neni 6	→ Osmani kundër Shqipërisë, Nr. 8706/18, 5 dhjetor 2023; → Ben Amamaou kundër Italisë, Nr. 49058/20, 29 qershor 2023;
Neni 8	→ Simonova kundër Bullgarisë, Nr. 30782/16, 11 prill 2023; → Wieder dhe Guarnieri kundër Mbretërisë së Bashkuar, Nr. 64371/16 dhe 64407/16, 12 shtator 2023; → Plechlo kundër Sllovakisë, Nr. 18593/19, 26 tetor 2023; → Gashi dhe Gina kundër Shqipërisë, Nr. 29943/18, 4 prill 2023;
Neni 10	→ Danilet kundër Rumanisë, Nr. 16915/21, 24 shkurt 2024; → Sanches kundër Francës, Nr. 45581/18, 15 maj 2023; → Pricope kundër Rumanisë, Nr. 60183/17, 30 maj 2023; → Mocatë kundër Lituanisë, Nr. 61435/19, 23 janar 2023; → Kompania e transmetimit Radio B92 AD kundër Serbisë, Nr. 67369/16, 5 shtator 2023.
Neni 11	→ Humpert dhe të tjerët kundër Gjermanisë, Nr. 59433/18; 59477/18; 59494/18, 14dhjetor 2023;
Neni 13	→ Altius Insurance LTD kundër Qipros, Nr. 41151/20, 24 tetor 2023;
Neni 1 i Protokollit 1	→ Bagirova dhe të tjerët kundër Azerbajxhanit, Nr. 37706/17 dhe të tjerat, 31 gusht 2023; → Zorina International SRL kundër Rumanisë, Nr. 15553/15, 27 qershor 2023; → Yordarov dhe të tjerët kundër Bullgarisë, Nr. 265/17 dhe 26743/18, 26 shtator 2023.



Embassy
of the Federal Republic of Germany
Pristina

FOL



KOSOVO LAW INSTITUTE
INSTITUTI I KOSOVËS PËR DREJTËSI
KOSOVSKI INSTITUT PRAVDE

INPO
Iniciativa për progres